

# **Edukata e kërkimit të dijes**



**(Muhamed ibn Salih el Uthejmin)**

# Edukata e kërkimit të dijes

**Muhamed ibn Salih el Uthejmin**

**Shkëputur nga "Kitabul ilm"**

**Përktheu: Tomor Boriçi**

## Përkufizimi i dijes

### Me emrin e Allahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshirëplotit

Falënderimet qofshin vetëm për Allahun. Paqja dhe shpëtimet qofshin mbi të dërguarin Muhamed, mbi familjen e tij, si dhe mbi të gjithë pasuesit e tij deri në Ditën e Gjykimit.

Nga ana gjuhësore dija është e kundërta e injorancës. Dija është kuptimi i një gjëje në mënyrë të vendosur, ashtu sikurse ajo është.

Nga ana terminologjike disa dijetarë kanë thënë se ajo është njohje, e kundërta e injorancës. Ndërsa disa dijetarë të tjerë kanë thënë se dija është më e qartë se njohja.

E rëndësishme për ne është dija e sheriatit islam. Me këtë është për qëllim dijen që Allahu i ka zbritur të Dërguari të Tij -salallahu alejhi ue selem- si sqarim dhe udhëzim. Dija, e cila ka falënderimin dhe lartësimin është dija e shpalljes, dija e zbritur vetëm prej Allahut.

Profeti -salallahu alejhi ue selem- ka thënë: **"Atij që Allahu i dëshiron të mirën e bën të kuptojë në fe"**. [Buhariu]

Gjithashtu, Profeti -salallahu alejhi ue selem- ka thënë: **"Vërtet, profetët nuk kanë trashëguar dinar e dërhëm, por kanë trashëguar dije. Kush e merr atë ka marrë një mirësi të madhe"**. [Ebu Daudi dhe Tirmidhiu]

Ajo që trashëguan profetët është dija e sheriatit dhe nuk trashëguan dije tjetër veç saj. Ata nuk trashëguan për njerëzit dije teknologjike dhe ato që lidhen me to.

Profeti -salallahu alejhi ue selem- kur erdhi në Medine i gjeti njerëzit që po pjalmonin hurma, kur pa lodhjen e tyre u tha: **"Nuk është e nevojshme për këtë."** Ata e lanë pjalminin, por hurmat u prishen. Më pas i Dërguari i Allahut -salallahu alejhi ue selem- u tha: **"Ju jeni më të ditur për çështjet e dynjasë suaj"**. [Muslimi]

Po të ishte kjo dija që duhej vlerësuar, do të ishte i Dërguari i Allahut -salallahu alejhi ue selem- që do t'u a mësonte njerëzve, sepse ai është që dallohet me dije dhe punë.

Dija e sheriatit është ajo e cila ka falënderimin dhe lartësimin për vepruesin e saj, por kjo nuk na bënë neve që të mohojmë dobitë e dijeve të tjera, kur ato ndihmojnë në bindjen ndaj Allahut, të fesë së Tij dhe kur robërit e Allahut bëjnë dobi me të. Kjo

është e mirë, pasi mësimi i kësaj dije nganjëherë mund të bëhet edhe e domosdoshme. Allahu i Lartësuar thotë: **"Dhe bëni gati kundër tyre gjithë fuqitë që keni, bashkë me kalorinë (dhe me mjetet e sotme më të përkryera për luftë)..."** [Enfal, 60]

Shumë prej dijetarëve kanë përmendur, se mësimi i dijeve të tjera është farz kifaje, pasi njerëzit i kanë më se të nevojshme enët për gatim e pirje, apo çështjet e tjera që u bëjnë dobi. Nëse nuk gjendet ndonjë që t'i prodhojë këto, atëherë mësimi i këtyre dijeve bëhet farz kifaje. Për këtë ka debate midis dijetarëve, por ajo që është e rëndësishme është dija e sheriatit, e cila është kuptimi i Kuranit dhe Sunetit, ndërsa tjetër veç saj ose është mjet për të mirë, ose për të keq. Gjykimi për të është në bazë të mjetit për tek ajo.

## Dobitë e dijes

Me të vërtetë Allahu ka falënderuar dijen dhe dijetarët, si dhe ka nxitur njerëzit për tek kjo dije. Dija është puna më e mirë dhe më e miri adhurim, ajo është një lloj xhihadi në rrugën e Allahut. Feja e Allahut ngrihet në dy çështje: dija dhe argumenti, lufta dhe shtiza.

Nuk mund të ngrihet feja e Allahut pa këto të dyja së bashku. Njëra më parësore se tjetra. I Dërguari i Allahut -salallahu alejhi ue selem- nuk ndryshonte ndaj një populli, derisa i përcillte atyre thirrjen për tek Allahu. Dija i paraprin luftës.

Allahu i Lartësuar ka thënë: **"A është ai i cili është i nënshtruar i Allahut, i cili bie në sexhde e qëndron në falje gjatë orëve të natës duke pasur frikë Jetën e Pastajme dhe duke shpresuar për Mëshirën e Zotit të tij (si ai që mohon e nuk beson)?..."** [Zumer, 9]

Ai që ngrihet natën bën sexhde dhe shpreson në mëshirën e Allahut nuk është i barabartë me atë që shfaq mendjemadhësi në bindjen ndaj Allahut, sepse vepra e tij që di është me dije. Allahu thotë: **"Thuaj: 'A janë ata që dinë, njësoj me ata që nuk dinë? Janë vetëm njerëzit e brumosur me mendje të shëndoshë të cilët me të vërtetë do të përkuqtojnë (e do të marrin mësim nga Fjalët dhe Shenjat e Allahut) ".** [Zumer, 9]

Nuk është i barabartë ai që di me atë që nuk di, sikurse nuk është i barabartë i gjalli me të vdekurin, ose ai që shikon me atë që nuk shikon, apo ai që dëgjon me atë që nuk dëgjon. Dija është drita, ku njeriu udhëzohet me të dhe del nga errësira në dritë.

Me të Allahu ngre cilindo prej krijesës së Tij, siç edhe thotë: **"...Që Allahu t'i lartësojë ata që besojnë dhe ata të cilëve u është dhënë dija në grada të larta..."**

[Muxhadele, 11]

Dijetarët meritojnë falënderimin, sa herë që përmenden, njerëzit i falënderojnë ata. Kjo është një ngritje për ta në dynja, kurse në ahiret ata do të ngrihen në bazë të thirrjes për tek Allahu dhe punëve që kanë kryer.

Adhuresi i vërtetë është ai, i cili adhuron Allahun me dije dhe i qartësohet e vërteta. Kjo është rruga e të Dërguarit të Allahut -salallahu alejhi ue selem-: **"Thuaj: (O Muhamed) 'Kjo është Udha ime; unë ju ftoj drejt Allahut (Njësimit të Tij) me dije të sigurt. Unë dhe kushdo që më ndjek mua (duhet të ftojnë në Islam). Lavdi i qoftë Allahut dhe unë nuk jam prej mushrikëve (politeistëve, paganëve, idhujtarëve ose çdo fe tjetër që mohon Njësinë e Allahut, ose adhuron të tjerë përkrah e në vend të Allahut)."** [Jusuf, 108]

Njeriu, i cili pastron vetveten e tij e di mirë që kjo është prej sheriatit dhe nuk është si ai i cili pastrohet, sepse shikon prindërit e tij që pastrohen. Padyshim ai që pastrohet e di që është urdhri i Allahut dhe vepra e Profetit -salallahu alejhi ue selem-, ndërsa tjetri e vepron, pasi është e zakonshme për të.

Kur marrim abdes a e ndjejmë se i bindemi Allahut në fjalën e Tij: **"O ju që keni besuar! Kur doni të kryeni faljen, lani fytyrat tuaja dhe duart tuaja deri në bërryla, kaloni duart e lagura mbi kokat tuaja, lani edhe këmbët deri në nyje..."** [Maide, 6]

A e sjellim ndërmend këtë ajet si bindje e urdhrit të Allahut dhe ndjekjes së të Dërguarit të Tij -salallahu alejhi ue selem- gjatë marrjes së abdesit? Padyshim se adhurimet duhet të jenë në bindje të urdhrit të Allahut dhe ndjekjen e të Dërguarit të Tij, sepse në këtë mënyrë vërtetohet sinqeriteti. Prej kushteve të saktësisimit të veprës është: sinqeriteti dhe ndjekja e Profetit -salallahu alejhi ue selem-.

Me këto të dyja vërtetohet dëshmia se nuk ka të adhuruar tjetër veç Allahut dhe se Muhamedi është i Dërguari i Tij.

Njeriu e adhuron Zotin e tij me dije, e lidh zemrën e tij me adhurimin dhe e ndriçon zemrën e tij me të, duke e ditur se ajo është adhurim dhe jo zakon.

## Dobitë më të rëndësishme të dijes

1. Dija është trashëgimi e profetëve. Profetët –paqja dhe bekimi i Allahut qoftë mbi ta!– nuk kanë trashëguar dinar e as dërhëm, por kanë trashëguar dije. Kush e merr atë ka marrë një mirësi të madhe.

2. Dija është e përhershme, kurse paraja është e përkohshme. Ebu Hurejra – kënaqësia e Allahut qoftë me të!– ka qenë një prej fukarenjve në mesin e sahabëve, rrëzohej prej urisë si t'i binte të fiktë. Ai kujtohet sot me dobinë e madhe që kanë sjellë hadithet e tij. Kjo tregon se dija është e përhershme dhe paraja është e përkohshme. Nxënësi i dijes duhet të kapet pas dijes. Në një hadith se i Dërguari i Allahut -alejhi selam- ka thënë: "**Kur rob i Allahut ndërron jetë, i ndërpriten të gjitha punët, përveç tri gjërave: sadakaja e rrjedhshme, dija me të cilën bëhet dobi, djali punëmirë, i cili lutet për babanë e tij.**" [Muslimi]

3. Dija nuk e lodh personin në ruajtje, sepse Allahu kur e furnizon robin me dije, dihet se vendi i saj është në zemër dhe nuk ka nevojë për kasaforta apo çelësa, pasi ajo (dija) ruhet në zemër dhe në të njëjtën kohë, me lejen e Allahut të ruan prej çdo vështirësie. Dija të ruan ndërsa paranë e ruan, e vendos atë në arka të mbyllura dhe përsëri nuk ndihesh i sigurt për të.

4. Njeriu duhet që të vazhdojë kërkimin e dijes, në mënyrë që të jetë prej dëshmuësve të së vërtetës.

Allahu thotë: "**Allahu dëshmon se La Ilahe il-la Huue (nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Atij); (dëshmojnë) edhe engjëjt, edhe ata që kanë mend e që dinë. Ai e mban Krijimin e Tij në Drejtësi të plotë. La Ilahe il-la Huue (askush nuk ka të drejtë, nuk meriton e nuk duhet të adhurohet përveç Atij), i Gjithëfuqishmi, më i Urti Gjithëgjykues.**" [Ali Imran, 18]

Allahu nuk thotë: "**të zotët e pasurisë**", por thotë: "**...ata që kanë mend e që dinë...**". Të mjafton ty, kërkues i dijes, krenaria për të dëshmuar se nuk ka të adhuruar tjetër me të drejtë përveç Allahut, me engjëjt, të cilët dëshmojnë në njësimin e Allahut.

5. Dijetarët cilësohen si udhëheqës, për të cilët Allahu ka urdhëruar që t'u bindemi dhe thotë: "**O ju që keni besuar! Binduni Allahut dhe binduni të Dërguarit (Muhamedit) dhe atyre prej jush të cilët janë në drejtimin dhe udhëheqjen tuaj...**" [Nisa, 59]

Fjala "**udhëheqës**" përfshin drejtues, udhëheqës, dijetarë, nxënës dije. Janë përgjegjësit të dijes në qartësimin e sheriatit dhe thirrjen e njerëzve në të, kurse përgjegjësia e drejtuesve është zbatimi i sheriatit dhe detyrimi i njerëzve me të.

6. Dijetarët janë ata të cilët gjenden gjithmonë në zbatimin e urdhrave të Allahut deri në Ditën e Gjykimit. Muauije -kënaqësia e Allahut qoftë me të!- thotë: "Dëgjova të Dërguarin e Allahut të thotë: '**Atij që Allahu i do të mirën i jep të kuptojë në fe. Unë jam ndarësi Allahu është Dhënësi. Do të ketë prej këtij umeti që nuk do t'i largohen urdhrave të Allahut dhe nuk do të dëmtohen prej kundërshtuesve**

**deri sa të vijë urdhri i Allahut'.**" [Buhariu]

Imam Ahmedi për këtë grup ka thënë: **"Nëse nuk janë dijetarët e hadithit, atëherë nuk e di se kush janë ata."**

Kadi Ajad –Allahu e mëshiroftë!– thotë: **"Imam Ahmedi ka për qëllim dijetarët e sunetit dhe kush beson në rrugën e dijetarëve të hadithit."**

7. I Dërguari i Allahut -alejhi selam- nuk lakmonte në begatinë e ndonjërit që Allahu ia jepte, me përjashtim të dy begative:

a) në kërkimin e dijes dhe të punuarit me të;

b) te tregtari, i cili e vuri pasurinë e tij në shërbim të Islamit.

Transmetohet nga Abdullah bin Mesudi –kënaqësia e Allahut qoftë me të!– tha se i Dërguari i Allahut -alejhi selam- ka thënë: **"Zilia është vetëm në dy gjëra. Personit që All-llahu i ka dhënë pasuri dhe e shpenzon atë në mirësi, si dhe personit që Allahu i ka dhënë dituri, gjykon me të dhe mëson të tjerët me të."** [Buhariu]

8. Transmetohet nga Ebu Musa el Eshari –kënaqësia e Allahut qoftë me të!– se Profeti -alejhi selam- ka thënë: **"Shembulli që Allahu më dërgoi me dije dhe udhëzim është si shembulli i shiut që bie në tokë ku një pjesë e mirë e saj e pranon shiun dhe mbijnë mbi të bimë të shumta. Ka prej saj që thahet e mban ujin dhe Allahu me të iu jep dobi njerëzve, të cilët pinë, ujin, mbjellin. Pjesa tjetër nuk e mbanë ujin dhe as nuk mbin bimë. Kjo është si shembulli i atij që kupton fenë e Allahut dhe i bënë dobi ajo me të cilën Allahu më dërgoi, mëson për vete dhe mëson të tjerët dhe shembulli i atij që nuk ngre kokën me këtë, nuk e pranon udhëzimin e Allahut me të cilin u dërgova."** [Buhariu]

9. Dija është rruga për në xhenet. Ebu Hurejra –kënaqësia e Allahut qoftë me të!– Profeti -alejhi selam- thotë: **"Kush merr rrugën për të kërkuar dijen, Allahu ia lehtëson atij me të rrugën për në xhenet".** [Muslimi]

10. Ajo që vjen në hadithin e Muaujijes –kënaqësia e Allahut qoftë me të!– i cili ka thënë se i Dërguari i Allahut -alejhi selam- tha: **"Atij që Allahu i do të mirën i jep të kuptojë në fe";** d.m.th: e bënë atë të ditur në fenë e Allahut. Me diturinë në fe nuk ka për qëllim dijen e gjykimit të veprimeve të veçanta të dijetarëve të fikhut, por qëllimi i tij është dija e njësimi, bazat e fesë dhe ajo çfarë lidhet me sheriatin. Edhe sikur të mos jetë në tekstin e Kuranit dhe Sunetit, ky hadith në dobi të dijes do të ishte i plotë për nxitjen e nxënësit të dijes për sheriatin dhe të kuptuarit të tij.

11. Dija është dritë ku robi ndriçohet me të. Ai me anë të asaj arrin të njohë se si të adhurojë Allahu, se si të trajtojë robërit e Tij dhe ecja e tij do të jetë me dije dhe

njohuri.

12. Dijetari është drita me të cilën udhëzohen njerëzit në çështjet e fesë dhe të dynjasë. **"Për këtë është historia e një personi nga beni israilet i cili kishte vrarë 99 njerëz. Ai pyeti për më të diturin në tokë dhe shkoi tek një adhurues dhe e pyeti atë: 'A ka për atë pendim?' Adhuruesi e zmadhoi çështjen dhe tha: 'Jo.' Personi e vret atë dhe plotësoi 100. Më pas shkoi te një i ditur dhe e pyeti atë: 'A ka pendim për atë?' Ai tha: 'Nuk ka pengesë midis tij dhe pendimit.' Më pas e drejton për në qytetin ku njerëzit e tij ishin punëmirë dhe në rrugë e kap vdekja..."** [Buhariu]

Shiko ndryshimin midis dijetarit dhe injorantit.

13. Allahu i ngre dijetarët si në dynja ashtu dhe në ahiret. Në ahiret Ai do t'i lartësojë ata në bazë të punëve apo thirrjes që kanë kryer në rrugën e Allahut, kurse në dynja i ngre midis njerëzve për atë që vepruan. Allahu thotë: **"Allahu t'i lartësojë ata që besojnë dhe ata të cilëve u është dhënë dija në grada të larta."** [Muxhadele, 11]

## Gjykimi për kërkimin e dijes

Kërkimi i dijes së shariatit është farz kifaje, nëse e kryejnë atë një pjesë e mjaftueshme dhe për të tjerët është sunet. Mund të jetë për njerëzit dhe farz ajn (detyrë) si kriter për njohjen e adhurimit dhe veprimin e tij, ose sjelljen që kërkon kryerjen e saj. Për këtë arsye njeriu e ka të domosdoshme të njohë se si të adhurojë Allahun me këto adhurime dhe si të kryejë këto sjellje. Kërkuesi i dijes duhet të ndjejë në vetveten e tij se po kryen këtë farz nga ku do të marrë shpërblimin për kryerjen e këtij obligimi e bashkë me të dhe dijen.

Nuk ka dyshim se kërkimi i dijes është prej punëve të mira, si lufta në rrugën e Allahut, posaçërisht në kohën tonë për shkak se:

1. Bidati ka filluar të shfaqet të keqën e tij dhe të përhapet dhe të shtohet në kolektivin mysliman.
2. Të shtohet injoranca dhe njerëzit të japin mendime në fe pa pasur dije.
3. Debatimet e shumta në çështjet ku për dijetarët janë të qarta, por vijnë pa pasur dije dhe kërkojnë të debatojnë.

Duke u nisur nga kjo ne e kemi të domosdoshme kthimin te dijetarët, pasi kanë dijen, kanë njohuritë për fenë e Allahut dhe kanë urtësinë për orientimin e njerëzve. Shumë prej njerëzve sot marrin dijen teorike në shumë çështje dhe nuk i intereson



përmirësimi i krijesës apo edukimi i tyre. Nëse ata do të japin mendime kështu e ashtu kjo do të jetë një mjet për tek një e keqe e madhe që Allahu e di se sa do të zgjasë.

## Edukata e kërkimit të dijes (pjesa e parë)

Për nxënësin e dijes ka një sërë edukatash të cilat konsiderohen bazë për të. Prej këtyre përmendim:

### 1. Sinqeriteti me zemër tek Allahu i Lartësuar

Qëllimi për kërkimin e dijes duhet të jetë për Allahun dhe për të mirat e botës tjetër. Sepse Allahu është nxitës për kërkimin e saj. Allahu thotë: **"Dije pra, se padyshim, La ilahe il Allah (Nuk ka të adhuruar tjetër të merituar pos Allahut), dhe kërk falje për gjnahun tënd..."**. [Muhamed, 19]

Falënderimi që Allahu u bënë në Kuran dijetarëve është i njohur. Dhe atë që Allahu e falënderon apo e urdhëron bëhet adhurim.

Atëherë sinqeriteti duhet të jetë për Allahun dhe qëllimi për kërkimin e dijes të jetë për Allahun. Nëse dikush për marrjen e dijes së shariatit ka si qëllim të marrë diplomën për të arritur post, Profeti -alejhi selam- ka thënë: **"Kush merr dije dhe kërkon me të fytyrën e Allahut dhe nuk e merr atë vetëm me qëllim që të zërë një post (pozitë) në dynja, ai nuk do të ndjejë shijen e xhenetit në Ditën e Gjykimit"** [E ka nxjerrë Imam Ahmedi (2/338), Ebu Daudi, Ibën Maxheh, El Hakim në Mustedrak (1/160), Ibën Ebi Shejbeh në "El Musanef". El Hakim ka thënë: "Ky hadith është i saktë dhe zinxhiri i transmetuesve të tij janë të besueshëm"].

Pra, ky është një kërcënim i ashpër...

Nëse nxënësi i dijes thotë se unë e dua diplomën jo me qëllim përfitimi në dynja, sepse kështu është ndërtuar sistemi, atij i thuhet: "Kur qëllimi i tij për të marrë diplomën është për shkak të dobisë së krijesës në mësimdhënien dhe administrim etj., ky qëllim është i shëndoshë dhe nuk e dëmton asnjë gjë, sepse ai është qëllimi i vërtetë".

Përmendëm sinqeritetin në fillim të edukatës së nxënësit të dijes, sepse sinqeriteti është baza dhe në kërkimin e dijes duhet të ketë për qëllim bindje ndaj urdhrit të Allahut, pasi Allahu urdhëroi për dije dhe tha: **"Dije pra, se padyshim, La ilahe il Allah (Nuk ka të adhuruar tjetër të merituar pos Allahut), dhe kërk falje për gjnahun tënd..."**. [Muhamed, 19]. Kur mëson je në ndjekje të urdhrit të Allahut.

## 2. Largimi i injorancës nga vetvetja dhe ndaj të tjerëve

Nxënësi i dijes në kërkimin e dijes duhet të ketë për qëllim largimin e injorancës nga vetvetja e tij dhe e të tjerëve, sepse origjina e njeriut është injoranca. Allahu thotë: **"Dhe Allahu ju ka nxjerrë nga mitrat e nënave tuaja duke mos ditur (ju) asgjë. Ai ju dha edhe dëgjimin, shikimin dhe zemrën që të mund të falënderoni (Atë)."** [Nahl, 78]

Realiteti dëshmon për këtë, pasi me këtë qëllim arrin frikën e Allahut. **"... Vërtet ata që i frikësohen më shumë Allahut nga robërit e Tij, janë dijetarët"** [Fatir, 28]

Ki si qëllim në vetveten tënde largimin e injorancës, sepse injoranca është në origjinën tënde kur mëson dhe bëhesh prej dijetarëve largohet prej teje injoranca, po ashtu ki si qëllim që të largosh injorancën prej popullit, gjë e cila bëhet me dije dhe me mjete të ndryshme e ku ata të kenë dobi me dijen tënde, Profeti thotë: **"Komunikoni prej meje edhe një ajet"**. [E ka nxjerrë Buhariu (Kitabul Enbija).]

Ti nëse do të mësosh një person dhe ai do të mësojë një person tjetër, ty të jepet shpërblimi i dy personave edhe nëse një i tretë merr dije ty të jepet shpërblimi i tre personave e kështu me radhë. Imam Ahmedi ka thënë: "Nuk i vlen dija atij që nuk ka qëllimin e saktë". Thanë: "Si është kjo?" Tha: "Të ketë si qëllim largimin e injorancës nga vetvetja e tij dhe nga të tjerët", sepse origjina tek ata është injoranca, siç është edhe te ty. Kur ti mëson, me qëllim për të larguar injorancën nga ky popull, do të jesh si ata të cilët luftojnë në rrugë të Allahut dhe përhapin fenë e Allahut.

## 3. Mbrojtja e sheriatit

Gjatë kërkimit të dijes duhet të kihet si qëllim mbrojtja e sheriatit, sepse librat nuk janë në gjendje ta mbrojnë sheriatin dhe ata të cilët e mbrojnë atë (sheriatin) janë njohësit dhe vepruesit e tij (sheriatis). Nëse një person i bidatit vjen në bibliotekë, e cila është e mbushur plot me librat e sheriatit, flet për bidatin nuk besoj se ndonjë prej librave do t'i përgjigjet atij, por kur ai flet për bidatin para një të dituri, ky i fundit do t'i përgjigjet atij dhe do ta përgënjeshtrojë fjalën e tij me fjalën e Allahut dhe të Dërguarit të Tij (me Kuranin dhe Sunetin).

Nxënësi i dijes në kërkimin e dijes duhet të ketë si qëllim mbrojtjen e sheriatit, pasi mbrojtja e tij bëhet vetëm prej njohësve të tij, si arma. Po të kemi një magazinë të mbushur plotë me armë a do të mundën këto armë të lëshojnë fishekët e tyre mbi armikun pa patur burra, të cilët i përdorin ato, natyrisht që jo; kështu është edhe dija.

Bidati rinovohet. Ka patur bidat që ka ndodhur në kohët e para dhe nuk ka qenë në libra dhe ai që mund të mbrohet prej tij është vetëm nxënësi i dijes. Njerëzit e kanë më se të domosdoshme nevojën për dijetarët me qëllim që t'u përgjigjen kurtheve të bidatçinjëve dhe gjithë armiqve të Allahut, gjë e cila arrihet me dijen e sheriatit të marrë nga Kurani dhe Suneti.

#### 4. Zemërgjerësia në çështjet e mospajtueshme

Gjoksi i tij, në çështjet e mospajtueshme, ku burimi i tyre është ixhtihadi (përpyjekja), duhet të jetë i hapur, sepse çështjet e mospajtuara midis dijetarëve ose janë në ato çështje ku nuk ka vend për ixhtihad (përpyjekje), janë çështje të qartë dhe askujt nuk i lejohet arsyetimi për kundërshtimin e saj, ose aty ku ka vend për ixhtihad (përpyjekje) dhe ka arsyetim për atë që kundërshton ato. Nuk duhet të jetë thënia jote argument ndaj atij që të kundërshton, sepse nëse ne pranojmë këtë do të themi të kundërtën, thënia e tij është argument mbi ty.

Me këtë kërkuj atë ku nuk ka vend për mendim nga ku njeriu kërkon mospajtim. Kush kundërshton rrugën e selefëve (të parëve) si në çështjet e acides, nuk ka kush që e pranon, kurse çështjet e tjera, të cilat kanë vend për mendim, nuk duhet të merret kundërshtimi si një demaskim ndaj të tjerëve dhe shkak për armiqësi dhe urrejtje.

Sahabët – kënaqësia e Allahut qoftë me ta! – nuk pajtoheshin në shumë çështje. Për këtë kush dëshiron le t'i kthehet gjurmëve të transmetuara që vijnë për ta dhe do të gjejë mospajtime në çështje të shumta. Ato janë më të mëdha se çështjet, të cilat njerëzit sot i kanë marrë zakon për mospajtim, saqë këto i përdorin si grupime, ku thonë se unë jam me këtë e atë person, sikur çështja të jetë e njëjtë me atë të partive, por kjo është e gabuar.

P.sh.: duke u nisur nga kjo dikush të thotë: "Nëse ngrihesh prej rukuje mos e vër dorën e djathtë mbi të majtë, por shtriji ato poshtë, nëse nuk e bën ti je bidatçi (shpikës në fe)".

Fjala bidatçi (shpikës në fe) në këtë çështje nuk është e thjeshtë, gjë e cila krijon te tjetri urrejtje. Kjo çështje është e gjerë ose i vendos duart ose i shtrinë ato. Imam Ahmed i – Allahu e mëshiroftë! – është në atë midis vendosjes së dorës së djathtë mbi të majtën dhe shtrirjes së tyre, por cili është suneti në këtë çështje ?

Suneti është të vendosësh dorën e djathtë mbi të majtën kur ngrihesh prej rukuje ashtu siç vendosen kur je drejt në këmbë. Argument është ajo që traseton Buhariu, e cila vjen nga Sehl bin Sad ku thotë: **"Njerëzit urdhëroheshin që në namaz të vendosnin dorën e djathtë mbi kypin e dorës së majtë"**. [E ka nxjerrë Buhariu

(Kitabu Sifatu es salat)].

Shiko! A kërkohet kjo kur kryen sexhden? Apo kërkohet kur kryen rukunë? Apo kur je ulur? Jo, ajo kërkohet kur je në këmbë (drejt), e cila përfshin qëndrimin në këmbë si para rukuje ashtu dhe pas saj.

Këtë mospajtim midis dijetarëve nuk duhet ta marrim si shkak grindjeje dhe konflikti, sepse çdokush prej nesh e do hakun (të vërtetën), dhe çdokush prej nesh vepron sipas ixhtihadit (përpjekjes) që bënë. Kur qenka kështu, nuk lejohet që ajo, e cila është midis dijetarëve, të merret si shkak për ndarje dhe armiqësi, sepse dijetarët kanë patur mospajtime të tilla edhe në kohën e Profetit.

Nxënësit e dijes e kanë të domosdoshme që të jenë si një dorë e vetme dhe të mos i kthejnë këto mospajtime shkak për ndarje dhe urrejtje.

Kur e kundërshton shokun tënd me argumentin që ke dhe ai të kundërshton ty me argumentin që ai ka duhet ta vendosni vetveten në një rrugë të vetme dhe duke e shtuar dashurinë midis jush.

Përgëzohen të gjithë ata që kanë drejtim të duhur dhe i afrojnë çështjet me argumente duke e ndërtuar dijen e tyre me Librin e Allahut dhe sunetin e Profetit. Kjo është e mirë, pasi hap dyert e dijes mbi një rrugë të saktë, e cila largon ndarjen në grupe dhe urrejtjen. Allahu i është drejtuar të Dërguarit të Tij: **"Vërtet ata që e ndajnë fenë e tyre dhe shpërndahen në sekte e grupe (të çfarëdolloj qofshin), ti (o Muhamed) nuk ke aspak të bësh me ta. Puna e tyre është vetëm me Allahun i Cili pas kësaj do t'u tregojë atyre çfarë ata vepronin."** [En'am, 159]

Ata të cilët kërkojnë të ndahen në parti (grupe) nuk do t'u pranohet, sepse partia e Allahut është një. Mospajtimi në kuptim nuk duhet të kthehet në urrejtje ndaj njerëzve ku ndonjëri të cenojë nderin e vëllait të vet.

Nxënësit e dijes duhet të jenë vëllezër midis njëri-tjetrit edhe nëse nuk pajtohen në disa nënçështje ku secili duhet të thërrasë tjetrin me qetësi dhe dialog, duke kërkuar me të Fytyrën e Allahut dhe arritje në dije. Në këtë mënyrë bashkohen zemrat, inati, ashpërsia që gjendet te disa njerëz largohet, pasi këto të çojnë në konflikte dhe armiqësi ku, padyshim, me këto do të kënaqen armiqtë e muslimanëve. Konflikti në popull është më i madh se dëmi. Allahu thotë: **"Binduni edhe Allahut, edhe të Dërguarit të Tij, mos u kundërshtoni (me njëri-tjetrin) që të mos humbni kurajën dhe të mos ju lënë fuqitë dhe jini të duruar e të qetë. Vërtet që Allahu është me të duruarit."** [Enfal, 46]

Sahabët midis njëri-tjetrit në të tilla çështje kishin mospajtim, por ishin si një zemër e vetme, në dashuri dhe harmoni me njëri-tjetrin.

Kur dikush të kundërshton me argumentin që ka, ai është dakord me ty për tek e vërteta, sepse të dy kërkoni të vërtetën dhe padyshim qëllimi në arritjen për tek e vërteta, duke u bazuar në argumente, është i njëjtë. Kur të kundërshton me argument që ka, ku është kundërshti?

Në këtë mënyrë populli mbetet në një rrugë të vetme edhe nëse nuk pajtohen në disa çështje që vjen argumenti. Kush është inatçi dhe mendjemadh pas shfaqjes së vërtetës nuk ka dyshim se ai do të trajtohet ashtu siç e meriton.

## 5. Të punuarit me dije

Kërkuesi i dijes duhet që të punojë me dijen e acides (besimit), fik'hut (jurisprudencës), moralit, edukatës dhe sjelljes, sepse puna është fryti dhe rezultati i dijes. Shembulli i atij që mban dijen është sikur shembulli i atij që mban armën, e cila mund të jetë për të ose ndaj tij.

Për këtë i Dërguari i Allahut – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me të! – thotë: **"Kurani është argument për ty ose mbi ty"** [E ka nxjerrë Muslimi (Kapitulli i Abdesit)].

Është për ty kur punon me të dhe është mbi ty kur nuk punon me të. Kështu është edhe puna, e cila saktësohet nga Profeti – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me të! – në vërtetimin e lajmit dhe ndjekjes së ligjeve. Kur vjen një lajm prej Allahut dhe të Dërguarit të Tij vërtetoheni dhe pranoheni atë e mos thuaj: si? pse? pasi kjo është jashtë rrugës së besimtarit.

Allahu thotë: **"Kur Allahu dhe i Dërguari i Tij kanë vendosur për një çështje, nuk i takon asnjë besimtari dhe asnjë besimtareje që në vendimin e tyre të bëjnë ndonjë zgjidhje tjetër. Dhe kushdo që nuk i bindet Allahut dhe të Dërguarit të Tij, padyshim që ka humbur në gabim të qartë."** Ahzab, 36.

Profeti – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me të! – u fliste shokëve për shumë çështje, të cilat ishin të panjohura dhe të pakuptueshme për ata. Ata i pranonin ato dhe nuk thoshin: si? pse? E kundërta ndodh me ata të cilët erdhën më pas prej këtij populli. Kur dikujt i thuhet një thënie prej thënieve të Profetit – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me të! – mendja e tij lëkundet duke gjetur si përgjigje ndaj fjalës së Profetit – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me të! – dëshirat, me të cilën kërkohet kundërshtimi dhe jo këshillimi. Ajo që ndodh midis tij dhe pranimit e bënë atë të kundërshtojë atë që ka ardhur nga Profeti – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me të! –

Si shembull për këtë është fjala e Profeti – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me të! –, i cili ka thënë: **"Allahu zbret në qiellin e dynjasë në një të tretën e fundit të natës"**

**dhe thotë: ‘Kush më lutet i përgjigjem atij, kush me kërkon i jap atij, kush kërkon falje e fal atë.’** [E ka nxjerrë Buhariu (Kitabu et Tehexhud) dhe Muslimi (Kitabu Salatu el Musafirin)].

Ky hadith është shumë i njohur dhe asnjë nga shokët e Profetit – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me të! – nuk ka thënë: “O i Dërguari i Allahut, si zbret Allahu? A lëviz Ai prej Arshit apo jo?” E të tjera të ngjashme me to.

Sot gjen disa njerëz, të cilët flasin për këto duke thënë: “Si është Allahu mbi Arsh dhe zbret në qiellin e dynjasë?” E të tjera të ngjashme me to, prej dëshirave që gjejnë. Nëse do ta pranonin këtë hadith do të thoshin: “Allahu qëndron mbi Arsh, zbret si të dojë”. Për të larguar këtë dyshim nuk do të luhateshin në atë që ka njoftuar Profeti për Allahun.

Është e domosdoshme për ne që çështjet e fshehta që na ka njoftuar i Dërguari i Allahut – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me të! – duhet t’i pranojmë ashtu sikurse kanë ardhur pa i kundërshtuar sipas mendjeve tona.

Besimtari hadithet e tilla duhet t’i pranojë dhe të thotë: “Të vërtetën ka thënë Allahu dhe i Dërguari i Tij.” Allahu thotë: **"I Dërguari (Muhamedi) beson në çfarë i është zbritur atij nga Zoti i tij."** [Bekareh, 285]

Besimi i pastër duhet të ndërtohet me librin e Allahut dhe sunetin e të Dërguarit të Tij. Njeriu duhet ta dijë se logjika nuk ka vend në të. Përsosmëria e Allahut, e cila ka ardhur në këtë libër, dëshmohet nga logjika. Kur logjika nuk arrin ta perceptojë se çfarë është e domosdoshme tek Allahu prej përsosshmërisë, por arrin të perceptojë se Allahu ka pohuar për të gjitha cilësitë e plota dhe padyshim ai duhet të punojë me këtë dije, me të cilën Allahu e mirësoi në aspektin e besimit.

Ndërsa në aspektin e adhurimit. Shumë prej nesh e dinë se adhurimi ndërtohet mbi bazën e dy çështjeve kryesore:

1. Sinqeriteti tek Allahu.
2. Ndjekja e të Dërguarit – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me të! –.

Njeriu duhet ta ndërtojë adhurimin e tij mbi atë që ka sjellë Allahu dhe i Dërguari i Tij. Ai nuk duhet të shpikë (të sjellë të reja) në fenë e Allahut, gjë të cilat nuk janë as në origjinën e adhurimeve, as në cilësinë e tyre. Patjetër adhurimi duhet të pohohet në sheriat (ligj) në përbërje, në vendin e tij, në kohën e tij dhe në shkakun e tij.

Nëse ndokush verifikon ndonjë prej shkaqeve për adhurim dhe e adhuron Allahun me to pa patur argument, ajo i refuzohet, sepse ai duhet ta verifikojë se ky shkak

është i këtij adhurimi. Nëse ndokush vjen në adhurime me ndonjë gjë që nuk ka ardhur sheriati, ajo i refuzohet atij nga vetë sheriati. Patjetër duhet të dihet se adhurimi ndërtohet me ato që na ka sjellë sheriati, sepse Allahu adhurohet vetëm me ato që Ai na ka njoftuar. Dijetarët kanë thënë se origjina në adhurim është nxjerrja e argumentit që e ligjëron. E argumentojnë me fjalën e Allahut: **“Apo kanë ata shokë e të barabartë me Allahun (zota të rremë të tyre) të cilët kanë themeluar e përcaktuar për ta ndonjë fe të cilën nuk e ka urdhëruar e përcaktuar Allahu?...”** [Shura, 21]

Profeti – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me të! – në hadithin e Aishes – kënaqësia e Allahut qoftë me të! – thotë: **“Kush kryen një vepër e cila nuk është në pajtim me çështjen tonë, ajo i refuzuar.”** [E ka nxjerrë Muslimi (Kitabul Ekdije)].

Edhe sikur të jeshë i sinqertë dhe të duash të arrish tek Allahu me një mënyrë jo të lejuar, ajo do të refuzohet, sepse rruga e zgjedhur është e tillë. Dhe nëse kërkohet të shkohet për tek Allahu me një rrugë që Allahu nuk e ka përcaktuar si të tillë, ajo do t'i refuzohet.

Atëherë për nxënësin e dijes është e domosdoshme që të jetë një adhurues, ashtu siç e mëson sheriati pa shtuar dhe pa pakësuar prej tij. Nuk duhet të thuhet se me çështjen të cilën dua të adhurojë gjen qetësin vetvetja ime, zemra ime e me të më hapet gjoksi, kjo derisa ta peshojë me peshoren e shariatit dhe nëse e dëshmon Kurani dhe Suneti ajo pranohet, në të kundërtën puna e tij e keqe ia zbukuron.

Allahu thotë: **“A është ai pra, të cilit e keqja e veprave të veta i duket sikur është e mirë, sa që ai e quan atë të mirë (njësoj me atë që është i udhëzuar drejt)? Vërtet që Allahu humb atë që Ai do dhe udhëzon atë që Ai do, kështu që mos e shkatërro veten në pikëllim për ta. Vërtet që Allahu është i Gjithëditur për gjithçka që ata veprojnë!”** [Fatir, 8]

Gjithashtu, ai duhet të jetë veprues me dijen e tij në moral, në sjellje, në shariat e të thërrasë çdo krijesë me vërtetësi dhe dashurinë e mirë ndaj çdo besimtari. I dërguari i Allahut – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me të! – thotë: **“Nuk do të besojë ndonjëri prej jush derisa të dojë për vëllanë e tij atë që dëshiron për veten”.** [E ka nxjerrë Buhariu (Kitabul Iman) dhe Muslimi (Kitabul Iman)].

Profeti – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me të! – thotë: **“Kush dëshiron të largohet prej zjarrit dhe të hyjë në xhenet kur t'i vijë vdekja, beson Allahun dhe Ditën e Gjykimit, të dëshirojë për njerëzit atë që dëshiron për vete.”** [E ka nxjerrë Muslimi (Kitabul Imara)].

Shumë prej njerëzve kanë xhelozë dhe dashuri për të mirën, por nuk punojnë me njerëzit me moralin e tyre, sa që dhe në daua shfaqin ashpërsi, gjë e cila bie në

kundërshtim me moralin që Allahu na ka urdhëruar. Duhet të dimë se morali më i mirë është ai që na afron tek Allahu.

Njerëzit më të lartë dhe më të afërt të Profetit – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me të! – janë ata të cilët e kanë moralin e mirë. Profeti – paqja dhe bekimi i Allahut qoftë me të! – thotë: **"Më të dashur dhe më të afërt prej jush tek unë në Ditën e Kiametit janë ata që kanë moralin e mirë. Më të urreyer dhe më të largët tek unë Ditën e Kiametit janë llafazanët, zgjatësit e fjalëve dhe mendjemëdhenjtë".**

[E ka nxjerrë Tirmidhiu (Kitabu el Biru ues sileh), Imam Ahmedi me tekst të përafërt, Begaviu në "Sherhus Suneh" dhe Hejthemi në "Mexhma ez Zevaid", dhe ka thënë (ky i fundit): "Këtë hadith e ka nxjerrë Ahmedi dhe Taberani, dhe transmetuesit e Ahmedit janë burra të hadithit të saktë."]

## 6.Thirrja për tek Allahu dhe durueshmëria gjatë kërkimit të dijes

Nxënësi i dijes duhet të thërrasë për tek Allahu me dijen e tij, në xhami, në mexhliis, në treg, në çdo shkas apo rast. Allahu kur i dha Profetit -alejhi selam- profetësinë ai nuk ndenji në shtëpinë e tij, por thërriste njerëzit.

Nxënësit e dijes nuk duhet të kthehen si kopje librash, por duhet të jenë si dijetar veprues.

Nxënësi i dijes duhet të bëjë durim gjatë kërkimit të dijes, nuk duhet të shpëputet nga ajo për asnjë çast dhe as nuk duhet të humbasë shpresën, por të vazhdojë kërkimin e saj sipas mundësisë që i jepet. Nëse e kap mërziçja ai dobësohet e derisa largohet, por kur qëndron në kërkimin e saj, ai merr shpërblimin e durimtarit nga një pamje dhe rezultatin në pamjen tjetër.

Allahu i thotë Profetit të Tij: **"Këto janë njoftime të gajbit (të së fshehtës, të së panjohurës) të cilat Ne t'i shpallim ty (O Muhamed), (të cilën) as ti dhe as populli yt nuk e dinte para kësaj (shpalljes), kështu që qetësohu, (se) padyshim fundi (i mirë) është për Muttekunët (të përkushtuarit në Besimin e Pastër Islam)." [Hud, 49]**

## 7.Urtësia e nxënësit të dijes

Nxënësi i dijes duhet të dallohet, cilësohet me urtësinë e tij. Allahu thotë: **"Ai i dhuron Hikmah (urtësinë, Pejgamberinë) atij që Ai dëshiron, dhe atij të cilit i është dhënë Hikmeti, vërtet që i është dhuruar mirësi e madhe..." [Bekare, 269]**

Këtë urtësi nxënësi i dijes duhet ta ushqejë te të tjerët me moralin dhe thirrjen e tij si dhe duke i folur njerëzve sipas gjendjes së tyre. Nëse do të arrihet kjo, atëherë kemi arritur një mirësi të madhe.



Allahu thotë: "**... dhe atij të cilit i është dhënë Hikmeti, vërtet që i është dhuruar mirësi e madhe...**" [Bekare, 269]

I urti: është ai i cili i vendos gjërat në vendin e duhur, pasi i urtë është marrë nga El-Ihkam (përpikëri, saktësi ) e cila është zotërim.

Zotërimi i një gjëje është vendosja e tij në vendin e duhur. Nxënësi i dijes duhet të jetë i përpiktë në thirrjen e tij.

Allahu përmend shkallët e thirrjes, i cili thotë: "**Ftoji (njerëzit o Muhamed) në Udhën e Zotit tënd me urtësi dhe me thirrje të nderhme dhe të bukur dhe bisedo me ta në mënyrën më të mirë...**" [Nahl, 125]

Gjithashtu, Allahu përmend si shkallë të katërt diskutimin me ithtarët e librit (çifutët dhe krishterët) dhe thotë: "**Dhe mos diskuto me popujt e Librave të Parë (me jehuditë dhe të krishterët), përveç se në një mënyrë që është më e mirë (me fjalë e punë të mira, me mirësjellje duke i ftuar ata në Islam me Vargjet e Tij), përjashtuar ata që bëjnë padrejtësi...**" [Ankebut, 46]

Nxënësi i dijes duhet të zgjedhë si mjete të thirrjes atë që është më afër pranimit.

Shembull për këtë është thirrja e Profetit -alejhi selam- kur malësori urinoi në xhami sahabët u ngritën për ta goditur, por i Dërguari i Allahut -alejhi selam- i ndaloi ata. Pasi e pastruan urinën i Dërguari i Allahut -alejhi selam- i tha malësorit: "**Në xhami nuk pranohen gjëra të tilla si: urina dhe ndytësitë, por në të përmendet Allahu, falet namazi, lexohet Kurani**" [Buhariu dhe Muslimi]

Kjo urtësi i hapi gjoksin malësorit, e bëri atë të bindet dhe të thotë: "O Zot, më mëshiro mua dhe Muhamedin e mos mëshiro me ne tjetërkënd".

Histori tjetër është nga Muauije Bin el Hakm es Selemi, i cili ka thënë: "**Falesha me të Dërguarin e Allahut -alejhi selam-, një person teshtiu e i thashë: Allahu të mëshiroftë. Njerëzit me shikimin e tyre dukeshin sikur po më flakëritnin dhe u thashë se çfarë ka që shikoni nga unë ? Filluan të godasin me duart mbi kofshët e tyre, e kuptova ata kërkonin që të heshtja. Kur Profeti -alejhi selam- mbaroi namazin, nuk kam parë mësues më të mirë se ai. Vallahi nuk urreu, nuk më goditi e nuk më shau, por më tha: 'Në namaz nuk pranohen fjalët e njerëzve, ai është tesbih, tekbir dhe lexim Kurani'."** [Muslimi ]

Prej kësaj nxjerrim se thirrja për tek Allahu duhet të jetë me urtësi, ashtu siç ka urdhëruar Allahu.

Shembull tjetër është se Profeti -alejhi selam- ka parë një person ku në dorën e tij mbante unazë floriri, dihet qartë se unaza e floririt për burrat është e ndaluar, Profeti -alejhi selam- ia heq atij nga dora dhe ia hedh atë dhe tha: **"Nëse ndonjëri prej jush do të mbështetet në një shkëdi zjarri, le të vendosi atë (unazën e floririt) në dorën e tij"**. [Muslimi]

E kur Profeti -alejhi selam- u largua, personit i thanë të merrte unazën dhe bëj dobi me të. Ai tha: **"Vallahi, nuk e marrë unazën që më hodhi Profeti"**.

Thirrësi në rrugën e Allahut e ka të domosdoshme që çështjet t'i vendosi në vendin e vet dhe njerëzit të mos i vendosi në një kategori. Po të mendojmë në atë që shumë prej thirrësve ndodhen sot do të gjejmë, disa prej tyre të përfshirë në xhelozzi sa që njerëzit largohen prej thirrjes së tij. Nëse gjen dikë që vepron vepër të ndaluar dhe e përhap atë me forcë e ashpërsi i thuhet: "A nuk i frikësohesh Allahut?" e të ngjashme me këto. derisa ai largohet prej tij. Kjo gjë nuk është e mirë sepse shfaq të kundërtën. Shejhu Islam Ibn Tejmija –Allahu e mëshiroftë!– ka thënë se i është thënë imam Shafiut –Allahu e mëshiroftë!–: **"Ç'mendon për njerëzit e fjalëve (filozofët)?"** Ai tha: **"Gjykimi im për njerëzit e fjalëve (filozofët) është të goditen me shkopinj dhe shapka"**. Thuhet se ky është shpërblimi për atë që lë librin e Allahut dhe sunetin e Profetit -alejhi selam-.

Shejhul Islam ka thënë: **"Njeriu kur i shikon ata thotë se e meritojnë atë që ka thënë Shafi'u. Kur i shikon ata me syrin e caktimit lëkundja dhe shejtani i ka pushtuar. Duhet të tregojë keqardhje dhe mëshirë si dhe të falënderojë Allahun që nuk është në sprovën e tyre. Atyre u është dhënë inteligjenca por nuk u është dhënë dëlirësia, u është dhënë të kuptuarit, por nuk u është dhënë dituria, u është dhënë të dëgjuarit, të shikuarit, zemra, por ato nuk i bëjnë dobi."**

Nxënësi i dijes duhet ta shikojë mëkatarin me syrin e ligjit dhe me syrin e caktimit.

Me syrin e ligjit d.m.th.: të mos marrim tek Allahu fajin e fajtorit. Allahu për imoralistin dhe imoralisten thotë: **"Gruaja dhe burri fajtorë për marrëdhënie të paligjshme jashtë martese, fshikullohen secili prej tyre me njëqind kamxhikë. Në zbatimin e dispozitave të Allahut mos u tregoni zemërbutë ndaj atyre dyve,..."** [Nur, 2]

T'i shikojmë ata me syrin e caktimit duke i mëshiruar e treguar keqardhje, si dhe të sillemi me ta në mënyrën më të mirë, me qëllim largimin e së keqes ku ata kanë rënë. Kjo është prej gjurmëve të nxënësit të dijes, e kundërta është te injoranti, i cili ka xhelozzi por nuk ka dije. Nxënësi i dijes si thirrës tek Allahu duhet të përdorë urtësinë në thirrje.

## 8. Nxënësi i dijes duhet të jetë i duruar në mësim

D.m.th. të vazhdojë me vendosmëri dhe pa ndërprerje në kërkimin e dijes aq sa të mundet. Të durojë me dijen dhe të mos mërzitet me të, sepse kështu ai arrin shpërblimin e durimtarëve nga njëra anë, dhe përfundim të mirë nga ana tjetër. Dëgjo Fjalën e Allahut drejtuar Pejgamberit të Tij (Paqja dhe bekimet e Allahut qofshin mbi të!): **“Këto janë (disa) nga lajmet e fshehta që Ne t’i shpallim ty. Këto nuk i ke ditur as ti, as populli yt para kësaj (shpalljes së Kuranit). Andaj, duro! Se, vërtet, në fund, fitorja është e të devotshmëve.”** [Hud, 49].

## 9. Respektimi i dijetarëve dhe vlerësimi i tyre

Nxënësit e dijes duhet të respektojnë dijetarët dhe t’i vlerësojnë ata, të hapin gjokset e tyre në mospajtimet që ata kanë midis tyre e të tjerëve veç tyre. Ti përballen kësaj me shfajësim ndaj atij që ndjek rrugë të gabuar. Kjo është një pikë e rëndësishme, sepse disa njerëz ndjekin gabimet e të tjerëve, marrin tek ajo atë që nuk i përshtatet të vërtetës së tyre duke prishur tek të tjerët imazhin e tyre; ky është gabimi edhe më i madh.

Përgojimi i një të thjeshti është prej gjynaheve të mëdha, ndërsa përgojimi i dijetarit është edhe më i madh. Përgojimi i dijetarit nuk pakëson të keqen e tij ndaj dijetarit, por është për të dhe ndaj asaj që ai ka prej dijes së shariatit.

Njerëzit kur braktisin një dijetar braktisin dhe fjalën e tij, edhe pse ai thotë të vërtetën dhe udhëzon me të. Përgojimi i këtij personi ndaj këtij dijetari përbën një rrezikshmëri të madhe si dhe një pengesë midis njerëzve dhe dijes së tij të shariatit, e cila përbën një rrezik të madh.

Këta të rinj, atë çfarë ndodh midis dijetarëve, duhet ta vështrojnë me nijet (qëllim) të mirë, ixhtihad (përpyetje) si dhe të kërkojnë ndjesë në atë që kanë gabuar.

Nuk ka pengesë nëse flet me ata për atë që ti e sheh gabim, pasi në këtë mënyrë qartëson se gabimi qëndron te dijetarët apo tek ata të cilët thonë: “Ata janë në gabim”.

Jo rrallëherë njerëzit krijojnë përshtypjen se fjala e dijetarit është gabim, por pas diskutimit gjithçka qartësohet mbi të vërtetën. Profeti thotë -alejhi salam-: **“Çdo bir i Ademit është gabimtar, më i miri nga gabimtarët është ai që pendohet”**. [Imam Ahmed etj]

Të kënaqurit me gabimin e dijetarit si dhe të përhapurit të saj te njerëzit krijojnë përçarje, kjo nuk është rruga e selefëve (të parëve).

Gjithashtu, gabimet që gjinden te prijësit nuk duhet të merren si shpifje në gjithçka e duke mos vënë në dukje prej të mirave të tyre.

Allahu thotë: **"O ju që keni besuar! Jini të fortë për Allahun dhe jini dëshmitarë të drejtë e mos lejoni që armiku dhe urrejtja ndaj të tjerëve t'ju bëjë që t'i shmangeni drejtësisë"**. [El Maide, 8]

Nënkuptojmë se nuk duhet të urrejmë një popull padrejtësisht.

Drejtësia është e domosdoshme. Nuk i lejohet askujt që gabimet e ndonjë drejtuesi, dijetari apo dikujt tjetër t'i përhap midis njerëzve e më pas të heshtë për të mirat e tij. Kjo nuk është drejtësi.

Imagjinoje këtë në vetveten tënde kur dikush të përhapë rrëshqitjet, gabimet e tua dhe të fshijë të mirat që ti ke vepruar, padyshim do ta konsiderojë si krim të tij ndaj teje. Kur ti këtë gjë e shikon në vetveten tënde, atëherë me këtë pamje duhet ta shikosh edhe te të tjerët.

Për kurimin e gabimit lidhu me atë që ti e shikon se ka gabime dhe diskuto me të e më pas qartëso qëndrimin tënde.

Shumë prej njerëzve pas diskutimit janë kthyer tek e sakta. Profeti -alejhi selam- thotë: **"Besimtari për besimtari janë si ndërtesat të lidhura fortë me njëra tjetrën"**. [Buhariu]

Profeti -alejhi selam- thotë: **"Kush dëshiron të largohet prej zjarrit të xhehenemit dhe të hyjë në xhenet kur ti vijë vdekja, të besojë Allahun dhe Ditën e Gjykimit dhe të dëshirojë te njerëzit atë që dëshiron për vetveten"**. [Muslimi]

Kjo është drejtësia dhe çiltërsia.

## **10. Të kapurit me Librin e Allahut dhe Sunetin e Profetit -alejhi selam-**

Për nxënësin e dijes lind e domosdoshme që të marrë dijen nga baza e tij e nuk do të ketë shpëtim për të nëse ai nuk e fillon me to, të cilat janë:

## Kurani

Nxënësi i dijes duhet të kujdeset për leximin e Kuranit, të mësuarit përmendësh, të kuptuarit si dhe të punuarit me të. Kurani është litari i fortë i Allahut dhe baza e dijeve.

Selefët tregonin një kujdes të madh për Kuranin ku e mësonin përmendësh në moshën shtatë vjeç e ku ndonjëri prej tyre e mësonte më pak se një muaj. E gjithë kjo tregon kujdesin e tyre për Kuranin.

Nxënësi i dijes duhet të përkushtohet në mësimin e Kuranit me një nga njohësit e mirë të tij (Kuranit). Lë për të dëshiruar të disa nxënës dije, të cilët nuk mësojnë nga Kurani si dhe ka prej tyre që nuk e këndojnë mirë. Ky është defekt i madh për kërkuesin e dijes. Nxënësi i dijes duhet të përkushtohet në të mësuarit e Kuranit përmendësh, të punuarit me të dhe thirrjen me të duke e kuptuar ashtu siç e kanë kuptuar selefët.

## Suneti

Kjo është baza e dytë e shariatit islam, e cila është qartësuese e Kuranit. Nxënësi i dijes duhet të kapet me të dyja dhe të tregojë kujdes për to. Ai duhet ta përvetësojë Sunetin, qoftë kjo me mësimin përmendësh të haditheve apo studimin e zinxhirit të tij, me qëllim që të jetë në gjendje të dallojë hadithin e saktë nga ai i dobët. Me këtë përvetësim ai është një mbrojtës i tij si dhe është në gjendje t'i përgjigjet dyshimeve të bidatçinjve (shpiksave në fe) në Sunet. Kurani dhe Suneti për nxënësin e dijes janë si krahët e zogut, nëse njëra prej tyre thyhet, ai nuk do të mund të fluturojë. Kështu dhe nxënësi i dijes nuk duhet ti përkushtohet vetëm Sunetit dhe të neglizhojë Kuranin apo e kundërta, t'i përkushtohet vetëm Kuranit dhe të neglizhojë Sunetin.

Shumë prej nxënësve të dijes i përkushtohen plotësisht Sunetit, shpjegimit të tij, burrave të tij dhe terminologjisë së tij e kur i pyet për një ajet kuranor do të gjesh se ai nuk ka njohuri për të, gjë e cila është një gabim i madh. Patjetër Kurani dhe Suneti janë krahët për nxënësin e dijes!

Por është dhe një e tretë e rëndësishme për të

## Fjala e dijetarëve

Mos neglizho në fjalën e tyre, sepse dija e tyre është shumë më e madhe se sa dije jote. Ata njohin rregullat, kushtet e shariatit gjë e cila nuk ndodhen te ty. Kur e saktësojnë një thënie thonë: "Nuk e themi atë vetëm nëse dikush e ka thënë".

Për shembull: Shejhul Islam Ibn Tejmia –Allahu e mëshiroftë!– tha: **“Unë e them atë**

**në qoftë se e kanë thënë.**" Ai nuk merr nga mendja e tij.

Në bazë të kësaj, nxënësi i dijes duhet të kthehet te libri i Allahut, Suneti i të Dërguarit të tij, si dhe të kërkojë ndihmë te fjala e dijetarëve. Kthimi te libri i Allahut është me të mësuarit, të kuptuarit të tij, si dhe të punuarit me atë që ai ka ardhur.

Allahu thotë: **"(Ky është) një Libër (Kuran) gjithë bekime e mirësi, të cilin Ne ta kemi zbritur ty me qëllim që ata të mendojnë e të thellohen në Vargjet e tij dhe që njerëzit e brumosur me mendje të shëndoshë të mund të përkujtojnë."** [Sad, 29]

**"...të mendojnë e të thellohen në Vargjet e tij..."** të menduarit në argumente arrin në të kuptuarin e plotë.

**"...njerëzit e brumosur me mendje të shëndoshë të mund të përkujtojnë"**

Përkujtimi është të punuarit me Kuranin.

Kurani ka zbritur me këtë urtësi, pikërisht për këtë duhet të kthehemi tek ai për t'u thelluar dhe e kuptuar atë e më pas të zbatojmë atë që ai ka sjellë. Në të është kënaqësia e dynjasë dhe i ahiretit (botës tjetër).

Allahu thotë: **"Pastaj, nëse ju vjen te ju (o njerëz) udhëzim prej Meje, atëherë kushdo që ndjek Udhëzimin Tim, nuk do të humbë e as nuk do të bjerë në mjerim e skamje. Por, kushdo që i kthen shpinën Mesazhit Tim, padyshim që për të do të ketë jetë të vështirë dhe Ne do ta ngremë të verbuar në Ditën e Ringjalljes."** [Ta-Ha, 123-124]

Për këtë nuk do të gesh ndokënd me gjoks të hapur e me një qetësi të plotë në zemrën e tij, veç besimtarit edhe nëse është i varfër. Besimtari është me gjoksin e hapur me një qetësi të plotë se çdokush tjetër.

Allahu thotë: **"Kushdo që punon të drejtën e të mirën, burrë a grua qoftë, duke qenë besimtar i vërtetë, sigurisht që Ne do t'i dhurojmë atij jetë të mirë (në këtë botë duke qenë i respektuar e i kënaqur dhe furnizim e jetesë sipas Ligjit të Allahut) dhe (në Botën Tjetër) Ne do t'ua paguajmë padyshim atyre shpërblimin sipas veprave të tyre më të mira që ata i kanë punuar."** [Nahl, 97]

**Kush është jeta e mirë?**

Jeta e mirë është hapja e gjoksit dhe qetësia e zemrës, edhe sikur njeriu të jetë në një mjerim të madh. I Dërguari i Allahut –alejhi selam– thotë: **"Çështja e besimtarit është interesante, ku çdo çështje e tij është e mirë, kjo jo për dikë tjetër vetëm"**

**për besimtarin. Kur e kap ndonjë e keqe duron e kjo është e mirë për të, kur e kap ndonjë e mirë falënderon e kjo është emirë për të."** [Shënuar nga Muslimi]

Jobesimtarin kur e kap ndonjë e keqe nuk bën durim, përkundrazi hidhërohet, i ngushtohet dynjaja, saqë arrin të vrasë dhe veten. Besimtari bën durim, gjen shijen e saj, është i qetë, pikërisht prej kësaj është jeta e tij e mirë.

Përmend Allahu **"...Ne do t'i dhurojmë atij jetë të mirë..."** në zemrën e tij dhe në vetveten e tij.

Disa historianë flasin për jetën e Hafidh bin Haxher –Allahu e mëshiroftë!–, i cili në kohën e tij ka qenë kryegjykatës në Egjipt. Shkonte në punë me karrocë që tërhiqesh me kuaj. Një ditë prej ditësh kalon një çifut që shiste vaj, dihet ai që shet vaj ka rrobën të pistë. Çifuti ndalon karrocën dhe i thotë Hafidh bin Haxherit –Allahu e mëshiroftë!–: Profeti juaj thotë se dunjaja është burg për besimtarin dhe xhenet për jobesimtarin. Shënuar nga Muslimi. Ti je gjykatës, je në këtë karrocë e në këtë mirësi, ndërsa unë jam në ndëshkim, në mjerim. Hafidh bin Haxheri –Allahu e mëshiroftë!– tha: “Unë jam në mirësi, por me mirësinë e xhenetit kjo konsiderohet burg, kurse në ndëshkimin që ti je me ndëshkimin e xhehenemit konsiderohet xhenet”. Çifuti tha: “Dëshmoj se nuk e meriton të adhurohet tjetër veç Allahut dhe se Muhamedi është i dërguari i Tij”, pranoi Islamin.

Besimtari në çfarëdo mirësie qoftë, është ai që fiton dynjanë dhe ahiretin. Jobesimtari në të keqe është ai që ka humbur dynjanë dhe ahiretin.

Allahu thotë: **"(Betohem) për kohën! Me të vërtetë që njeriu është në humbje të plotë, përveç atyre që besojnë (në Besimin e Pastër Islam, në Një Zot) dhe punojnë mirësi e drejtësi, edhe që e këshillojnë njëri-tjetrin për El-Hak (për të vërtetën; urdhërojnë për El-Ma'ruf - që ka urdhëruar Allahu dhe ndalojnë nga El-Munker - e keqja që ka ndaluar Allahu), edhe që e këshillojnë njëri-tjetrin të jenë të durueshëm (nga vuajtjet, mundimet, dëmtimet që i bien njeriut nga përpjekja për Çështjen e Allahut, për të përhapur Fenë e Tij të Vërtetë të Besimit të Pastër Islam deri në xhihad)." [Asr, 1-3]**

Jobesimtari, i cili ka humbur fenë e Allahut, ka humbur të mirat, shijimin e tyre edhe sikur të ndërtojë në dynja ndërtesa të fortifikuara, të larta, ai në të vërtetë do të jetë në xhehenem.

Disa selef (të parët tanë të mirë) thonë: **"Sikur ta dinë mbretërit, fëmijët e tyre në atë ku ne jemi do të na godisnin me shpatat e tyre".**

Besimtarët janë, në mirësinë e besueshme të Allahut, në caktimin e tij. Kur u vjen ndonjë e keqe durojnë e kur u vjen ndonjë e mirë falënderojnë. E kundërta ndodhte

me njerëzit e dynjasë.

Ata ishin ashtu sikur i cilësoi Allahu: **"Në qoftë se ata marrin hise prej saj, janë të kënaqur, por nëse nuk u jepet gjë prej saj, kur ç'të shohësh! Janë bërë si të tërbuar!"** [Teube, 58]

Suneti i Profetit –alejhi selam– është i qartë, i ruajtur midis duarve tona edhe kur trillonin ndaj të Dërguarit të Allahut –alejhi selam– dijetarët e qartësonin Sunetin e tij. Çdo njeri ka mundësi të arrijë tek ajo, qoftë me anë të librit ose duke pyetur dijetarët.

Në qoftë se dikush thotë se si pranohet ajo që thoni për kthimin në librin e Allahut dhe Sunetin e të Dërguarit të Tij –alejhi selam– kur në të njëjtën kohë gjejmë njerëz që ndjekin librat e disa autorëve të medhhebeve dhe thonë se medhhebi im është ky, tjetri po të njëjtën gjë, e kur i thua se i Dërguari i Allahut –alejhi selam– ka thënë këtë..., ai thotë se unë jam medhheb hanefi, tjetëri thotë jam medhheb maliki e të ngjashme me këto.

I themi të gjithëve se ne dëshmojmë se nuk ka që e meriton adhurimin tjetër veç Allahut dhe Muhamedi është i Dërguari i Tij.

### **Çfarë kuptimi ka dëshmia se Muhamedi është i Dërguari i Allahut?**

Dijetarët, për kuptimin e saj, kanë thënë: **"Bindja në atë që ai ka urdhëruar, vërtetimi i asaj që ai ka lajmëruar, largimi prej asaj që ka ndaluar dhe të adhurojmë Allahun në bazë të asaj që ai na ka sjellë"**. Në rast se dikush thotë: "Unë jam në këtë medhheb e atë medhheb" i themi atij se kjo është fjala e të Dërguarit të Allahut –alejhi selam– dhe mos e kundërshto atë me thënien e ndokujt.

Imamët e medhhebeve e kanë ndaluar imitimin e tyre dhe thonë: **"Kur të qartësohet e vërteta është uaxhib kthimi për tek ajo"**.

Kush kundërshton me medhheb filani apo filani i themi se ne dhe ti dëshmojmë se Muhamedi është i Dërguari i Allahut, në bazë të kësaj duhet të ndjekim vetëm të Dërguarin e Allahut –alejhi selam–.

Ky Suneti, i cili ndodhet në duart tona, është i qartë e i sigurt. Me këtë nuk kërkohet të pakësohet rëndësia që kanë librat e fukahave dhe dijetarëve. Kthimi në librat e tyre për dobi dhe njohjen e rrugëve prej të cilave dalin gjykimet dhe argumentet, ku nxënësi i dijes nuk mund t'i vërtetojë vetëm nëpërmjet kthimit për tek ato.

Ata të cilët nuk e marrin fenë nga dijetarët, kanë një rrëshqitje të madhe, sepse ata shikojnë me një shikim më të ngushtë nga ajo që duhet të shikojnë në të.



P.sh: shkojnë në hadithet e Buhariut, ku dihet në to ka hadithe përmbledhëse, të veçanta, të pakufizuar, të kufizuar, të abroguar, por ata nuk e kuptojnë këtë dhe hyjnë në një humbje të madhe.

## 11.Verifikimi dhe siguria

Verifikimi është një edukatë e rëndësishme, nxënësi i dijes duhet të cilësohet me të. Ai duhet të verifikoj lajmin që përcjell si dhe atë që nxirret prej ligjeve.

Lajmi para se të përcillet duhet të verifikohet për saktësinë apo jo prej atij që e përcjell. E kur të saktësohet dhe verifikohet në gjykim, ndoshta është gjykimi, të cilin e ke dëgjuar, i ndërtuar mbi origjinën, por ti nuk ke njohuri për të. E gjykon si gabim, kurse në realitet ai nuk është gabim.

Cili është ilaçi në këtë rast?

Të lidhet me atë të cilin i dedikohet lajmi duke i thënë atij se përcillet prej teje kjo e kjo, a është i saktë? Më pas të diskutohet me të ose është ai në të saktën e ti të kthehesh tek ajo, ose ti je në të saktën dhe ai duhet të kthehet tek ajo.

Me siguri kuptojmë të duruarit, këmbëngulje, mos humbjen e shpresës, mos mërzitja dhe mos të merret prej çdo libri copëza apo në çdo art pjesë e më pas të lihen, sepse kjo e dëmton nxënësin e dijes ku ditët i kalojnë pa dobi.

Disa nxënës për shembull, lexojnë në gramatikë herë nga libri **“El Axhrumije”** p.sh, herë nga libri **“Katru en Nida”**, dhe herë nga **“Elfijetu Ibni Malik”**. Po kështu edhe në Terminologjinë e Hadithit; herë lexojnë nga libri **“En Nuhbe”**, herë nga **“El Elfije”** e El Irakit. Po kështu në Fikh, herë lexojnë nga **“Zadul Mustekni”**, herë nga **“Umdetul Ahkam”**, herë nga **“El Mugni”** dhe herë nga **“Sherhul Muhedheb”**. E kështu me çdo libër të çdo fushe, por në shumicën e rasteve diçka e tillë nuk sjell përfitim në dije. Edhe nëse arrin ndopak dije, ajo dije lidhet me degët dhe jo me bazat, dhe mësimi i degëve një nga një është si ai që kap karkaleca një nga një. Bazat, qëndrueshmëria janë shumë të rëndësishme, bëhu i qëndrueshëm në librat që lexon apo kërkon si dhe bëhu i qëndrueshëm edhe te shujhët prej të cilëve merr. Vendos se te ai do të marrësh dijen pasi ta vendosësh bëhu i qëndrueshëm e mos u bë që në çdo javë apo muaj të kesh shejh.

Nuk ka problem nëse ke shejh në fikh dhe të vazhdosh me të në fikh dhe të kesh shejh tjetër në akide e kështu me radhë. E rëndësishme të vazhdosh e të mos bëhesh si një person sa herë që martohet me një grua qëndron me të disa ditë e divorcon

dhe më pas kërkon tjetër.

Gjithashtu, verifikimi është një çështje shumë e rëndësishme, sepse përcjellësit nganjëherë kanë synim të keq. Përcjellin qëllimisht imazhin e keq ndaj atij që e ka sjellë. Nganjëherë ata nuk kanë qëllim të keq, por e kuptojnë të kundërtën e asaj që kërkohet. Për këtë duhet verifikimi. Nëse saktësohet me zinxhir ajo që përcillet, vjen radha e dialogut me personin që përcillet ndaj tij, para se të gjykohet mbi thënien gabim apo jo gabim, sepse pas dialogut mund të dalë se e vërteta është me atë që i përcillet thënia.

Ajo që përcillet ndaj një personi kur e sheh gabim duhet të ndjekësh tri rrugë:

1. Verifikimi për saktësinë e lajmit
2. Shikimi në saktësinë e gjykimit, nëse është i saktë përkrahje dhe mbroje atë, në qoftë se është gabim ndiq rrugën e tretë.
3. Lidhu me atë që i dedikohet thënia për të diskutuar me të me qetësi e respekt.

## **12.Kujdesi për kuptimin e asaj që ka për qëllim Allahu dhe i Dërguari i Tij -alejhi salam-**

Një prej çështjeve të rëndësishme për nxënësin e dijes është çështja e të kuptuarit, d.m.th: të kuptuarit të qëllimit të Allahut dhe të Dërguarit të Tij -alejhi salam-.

Shumë prej njerëzve u është dhënë dija, por nuk u është dhënë të kuptuarit. Nuk mjafton të mësosh librin e Allahut dhe çfarë të lehtësohet prej Sunetit pa e kuptuar ashtu sikur do Allahu dhe i Dërguari i Tij -alejhi salam-.

Shumë prej defekteve të njerëzve është se argumentojnë me argumente që nuk kanë për qëllim atë që do Allahu dhe i Dërguari i Tij -alejhi salam- me të cilën shkojnë në humbje.

Gabimi në të kuptuarit është shumë më i rrezikshëm se gabimi nga injoranca, sepse injoranti gabon me injorancën e tij, pasi njihet si i tillë dhe mëson. Fatkeqësi është kur ai i cili e kupton gabim dhe mendon në veten e tij se është dijetar si dhe mendon se ky është qëllimi i Allahut dhe i të Dërguarit të Tij -alejhi salam- .

Le të sjellim disa shembuj qartësues për rëndësinë e të kuptuarit.

### Shembulli i parë:

Ka thënë Allahu: "**(Kujto) edhe Daudin dhe Sulejmanin kur gjykuan për rastin e arës në të cilën dhentë e dikujt kishin kullotur natën dhe Ne qemë Dëshmues të Gjykimit të tyre. Dhe Ne e bëmë Sulejmanin ta kuptojë çështjen dhe secilit prej tyre Ne i dhuruam Hukmin (Gjykimin e drejtë, Urtësi dhe Pejgamberi) dhe Dije (të fesë së Allahut) dhe i nënshtroam malet dhe zogjtë të lavdërojnë Madhështinë Tonë bashkë me Daudin. (E të gjitha këto) ishim Ne që i bënim".**  
[El Enbija, 78-79]

Allahu i Lartësuar e dalloi Sulejmanin nga Daudi në këtë çështje me të kuptuarit. "**Dhe Ne e bëmë Sulejmanin ta kuptojë ...**" Kjo nuk do të thotë se Daudi ka mangësi në dije "**... Ne i dhuruam Hukmin (Gjykimin e drejtë, Urtësi dhe Pejgamberi) dhe Dije (të fesë së Allahut)...**"

Në këtë ajet kuranor vërehet qartë dallimi i Sulejmanit me të kuptuarit, gjithashtu dhe Daudi dallohet. Allahu thotë: "**... dhe i nënshtroam malet dhe zogjtë të lavdërojnë Madhështinë Tonë bashkë me Daudin...**" Kjo është e drejta e çdo njerit prej tyre.

Allahu i përmend si pjesëmarrës në gjykim dhe dije, më pas çdonjërin prej tyre e dallon. Kjo tregon rëndësinë e të kuptuarit, kurse dija nuk është gjithçka.

### Shembulli i dytë:

Kemi dy enë, një me ujë të nxehtë dhe tjetra me ujë të ftohtë, në një kohë dimri. Vjen një person dhe do të lahet prej xhunubit dhe disa njerëz i thonë se më e mirë është të përdorësh ujin e ftohtë, sepse aty është sakrifica, sepse i Dërguari i Allahut -alejhi selam- thotë: "**A doni t'ju tregoj juve se si Allahu ju fshin juve gabimet dhe ju ngre në grada?**" Ata i thanë: "Po, o i Dërguari i Allahut." Ai tha: "**Plotësojeni abdesin në vështirësi...**" [Shënuar nga Muslimi]

D.m.th. të lash mirë gjymtyrët gjatë abdesit në ditët e ftohta, dhe që ta bësh këtë me ujë të ftohtë është më mirë se me ujë të ngrohtë për t'ju përshtatur motit, sipas tij.

Pra, ky njeri jep fetva se përdorimi i ujit të ftohtë është më mirë dhe solli argument hadithin e mësipërm. A është gabimi këtu në dije apo në të kuptuar?

Përgjigja: Sigurisht që gabimi këtu është në të kuptuar, sepse Pejgamberi (Paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi të!) ka thënë: "**Marrja mirë abdes kur ka mundim**" dhe nuk ka thënë që të zgjedhësh ujin e ftohtë për të marrë abdes. Kuptimi i hadithit është: "Nuk duhet që njeriun ta ndalojë fakti se uji është i ftohtë nga të marrët mirë abdes."

Përveç kësaj themi: A do Allahu lehtësim për robët e Tij, apo vështirësim?

Përgjigja është në Fjalën e Allahut: **"...Allahu ju dëshiron juve të lehtën dhe Ai nuk do që t'i vështirësojë gjërat për ju..."** [El Bekare, 185]

Apo thënia e të Dërguarit të Allahut -alejhi selam-: **"Me të vërtetë feja është e lehtë."** [Shënuar nga Buhariu]

Nxënësi i dijes duhet ta dijë se çështja e të kuptuarit është një çështje shumë e rëndësishme. Ne duhet ta kuptojmë atë që ka për qëllim Allahu për robin e Tij dhe jo ta vështirësojmë.

Këto edukata, për nxënësin e dijes, duhet të ndikojnë në dijen e tij në mënyrë që ai të jetë shembull me punën e tij, një thirrës i mirë dhe prijës në fenë e Allahut.

Durimi, siguria i japin drejtimin në fe.

Allahu thotë: **"Dhe Ne bëmë nga mesi i tyre prijës duke udhëzuar nën Urdhrin Tonë kur qenë të duruar dhe gjithnjë besuan me vendosmëri në Ajetet Tona (provat, shenjat, shpalljet Tona)".** [Sexhde, 24]

## Shkaqet ndihmuese për kërkimin e dijes

Shkaqet që ndihmojnë në kërkimin e dijes janë të shumta, por do të përmendim vetëm disa prej tyre.

### Së pari: Et-Takua (Frika)

Ajo është këshilla e Allahut për të parët dhe të fundit prej robërve të Tij.

Allahu thotë: **"...Ne i kemi këshilluar popujt e Librave të Parë (jehuditë dhe të krishterët) përpara jush, e tash edhe ju (o muslimanë), që të gjithë ju të keni frikë Allahun dhe të plotësoni detyrimet ndaj Tij, por në qoftë se mohoni, atëherë padyshim se të Allahut janë gjithë ç'ka në qiej dhe gjithë ç'ka në tokë dhe se Allahu kurdoherë është më i Pasuri (i Lirë nga çdo nevojë) dhe i denjë për të gjitha lavdërimet."** [Nisa, 131]

Gjithashtu, ajo është këshilla e të Dërguarit të Allahut -alejhi selam- për umetin e tij. Transmetohet nga Ebu Emameh Sadi bin Axhlan el Bahili -kënaqësia e Allahut qoftë me të!- të ketë thënë se e ka dëgjuar të Dërguarin e Allahut -alejhi selam- të thotë në hutben e haxhit të lamtumirës: **"Frikësojuni Zotit tuaj, falini pesë namazet, agjëroni ramazanin, jepni zekatin e pasurisë suaj, binduni prijësve tuaj që Zoti**

**jua t'ju fusë në xhenet".** [Tirmidhiu 616. Shejh Albani e ka konsideruar Sahih, në Es Silsiletu es Sahiha 867].

Kur Pejgamberi dërgonte ndonjë komandant me grup zbulimi, e porosiste në veçanti për devotshmëri ndaj Allahut në veten e tij dhe që të kishte kujdes muslimanët që kishte me vete.

Të parët e pastër nuk i kanë ndërprerë këshillat e tyre, në hutbe, në libra. Umer bin Hatabi – kënaqësia e Allahut qoftë me të! – i ka shkruar djalit të tij Abdullait: "Të këshilloj me frikë ndaj Allahut. Kush i frikësohet Atij e parandalon atë, kush i huazohet e shpërblen atë, kush e falënderon ia shton atij".

Umer ibën el Hatab i shkroi birit të tij, Abdullahit: **"Unë të porosis për devotshmëri ndaj Allahut të Madhëruar, sepse kush i ruhet Allahut, Allahu e ruan atë, kush i jep borxh Atij (duke i dhënë sadaka të varfërve), Ai e shpërblen atë dhe kush e falënderon Atë, Ai ia shton atij."**

Po kështu Aliu – kënaqësia e Allahut qoftë me të! – një personi i tha: **"Të këshilloj me frikë ndaj Allahut, patjetër do ta takosh Atë. Nuk ka mbarim për ty pa Atë, Ai është Sunduesi i kësaj bote dhe botës tjetër."**

Një prej salihinëve (punëmirësve) shkroi për vëllanë e tij në fe: **"...Të këshilloj që t'i frikësohesh Allahut ... Dije se ti je në shikimin e Tij nuk del prej autoritet të Tij në autoritetin e dikujt tjetër, as prej sundimit të Tij në sundimin e dikujt tjetri."**

Kuptimi i frikës: Robi midis vetes dhe asaj që ai i frikësohet vendos parandalimin prej frikës së tij.

Kurse frika e robit ndaj Zotit të tij është: midis tij dhe Atij që ai i frikësohet prej hidhërimit, poshtërimit duke e parandaluar me vepra bindëse ndaj Tij dhe largimi prej mëkateve.

Frika nganjëherë afrohet me mirësinë. Allahu thotë: **"...por ndihmoni njëri-tjetrin në mirësi e frikë ndaj Allahut..."** [Maide, 2]

Afrimi me mirësi e bënë atë vepër urdhëruese në të mira, kurse frikën ndaluese prej të këqijave.

Allahu përmend në librin e Tij se xheneti është përgatitur për ata që i frikësohen

Atij.

Njeriu duhet t'i frikësohet Allahut duke ju bindur urdhrave të Tij, të kërkojë shpërblimin e Tij dhe shpëtimin prej ndëshkimit.

Allahu thotë: **"O ju që keni besuar! Në qoftë se i nënshtroheni Allahut dhe e keni frikë Atë, atëherë Ai do t'ju garantojë juve një Furkan (parim për të gjykuar mes së drejtës dhe të gabuarës ose makhaxh – që ju hap rrugë për të dalë nga çdo vështirësi) t'ju fshijë të gjitha gjynahet dhe t'ju falë ju. Dhe Allahu është Zotëruesi dhe Dhuruesi i Mirësive të Mëdha".** Enfal, 29.

Ky ajet ka tre dobi të rëndësishme:

**Dobia e parë: "... Ai do t'ju garantojë juve një Furkan ..."**: do të dalloni me të të vërtetën nga e kota, dëmin nga dobia. Këtu hyn dija dhe Allahu i hap njeriut prej dijeve ku nuk ia hap tjetërkujt. Me frikën shtohet udhëzimi, dija, të mësuarit. Imam Shafiu thotë:

U ankova te Ueki për të mësuarin e keq  
Më drejtoi për lënien e mëkatit  
Dhe tha: Dije se Dija është dritë  
Drita e Allahut nuk vjen te mëkatari

Njeriu sa herë që shton dijen, shton njohjen dhe arrin të dallojë të vërtetën nga e kota, dëmin nga dobia. Këtu hyn kuptimi, sepse frika është shkak për forcën e të kuptuarit, kjo arrihet me shtimin e dijes.

Janë dy persona që mësojnë një ajet kuranor, njëri prej tyre është në gjendje të nxjerrë prej saj tre dobi, kurse tjetri edhe më shumë, kjo sipas të kuptuarit që Allahu i ka dhënë atij.

Frika është shkak për shtimin e të kuptuarit. Kjo është një mjeshtri që Allahu ia jep atij që i frikësohet dhe me të ai dallohet midis njerëzve. Kur shikon një person e njeh që është gënjeshtar apo i sinqertë, i mirë apo i keq, ndoshta ai gjykon mbi personin edhe pse nuk e njehë, nuk jeton me të, kjo si shkak i mjeshtërisë që Allahu i ka dhënë.

**Dobia e dytë: "... t'ju fshijë të gjitha gjynahet ..."** Fshirja e gjynaheve bëhet me punë të mira. Thotë i Dërguari i Allahut -alejhi selam- : **"Pesë namazet, xhumaja deri në xhuma, ramazani deri në ramazan fshin çfarë ka midis të dyjave, përveç mëkateve të mëdha"**. [Muslimi 233].

I Dërguari i Allahut -alejhi selam- thotë: **"Umra deri në umra fshih çfarë janë midis tyre"**. [Buhariu 1773, Muslimi 1349].

Frika ndaj Allahut lehtëson veprat e mira, me to Allahu fshin gjynahet.

**Dobia e tretë:** " ... dhe t'ju falë ju ..." ju lehtëson për të kërkuar falje dhe pendim. Kjo është mirësia e Allahut që i jep robit të Tij.

## Së dyti: Këmbëngulja dhe vazhdueshmëria në kërkimin e dijes

Nxënësi i dijes duhet të bëjë përpjekje, durim për marrjen e dijes si dhe ta ruaj atë pas marrjes. Ajo nuk merret duke ndenjur në rehati, por duhet të kërkohen të gjitha rrugët që të çojnë për te ajo. I Dërguari i Allahut -alejhi selam- thotë: "**Kush merr rrugën me qëllim për të kërkuar dijen Allahu i lehtëson atij rrugën për në xhenet**". [Nxjerrja e tij është përmendur më parë].

Nxënësi i dijes duhet të jetë këmbëngulës, përpjekës, të qëndroj natë të tëra dhe të lërë çdo gjë që e shmang dhe e largon prej kërkimit të dijes.

Te të parët tanë ka qenë e njohur këmbëngulja në kërkimin e dijes. Transmetohet nga Ibn Abasi –kënaqësia e Allahut qoftë me të!–, i cili është pyetur se si e ka marrë dijen dhe ka thënë: "**Me gjuhën pyetëse, me zemrën e shëndoshë dhe me trup të palodhur**".

Është përcjellë gjithashtu nga Ibën Abasi (Allahu qoftë i kënaqur me të!) se ai ka thënë: "**... Kur mësoja se dikush dinte një hadith, shkoja te dera e shtëpisë së tij, dhe ndërsa ai pushonte në kohën e drekës, unë shtroja rrobën time dhe mbështetsha para derës së tij dhe era më hidhte pluhurin në fytyrë. Kur ai dilte, më thoshte: "O biri i xhaxhait të Pejgamberit, çfarë të ka sjellë këtu? Përse nuk dërgove dikënd të më kërkove që të vija?" Ndërsa unë i thosha: "Unë e kam për detyrë që të vij tek ti. Pastaj e pyesja për hadithin..."**" Pra, Ibën Abasi ishte i thjeshtë në kërkimin e dijes, ndaj Allahu e ngriti atë me dijen.

Kështu duhet të jetë nxënësi i dijes, të këmbëngulë shumë në kërkimin e dijes.

Transmetohet nga Shafiu –Allahu e mëshiroftë!– se imam Ahmedi një natë e ftoi për darkë. Hëngri Shafiu dhe shkuan për të fjetur. Shafiu qëndroi dhe mendonte që të nxirrte dobi prej hadithit të të Dërguarit të Allahut -alejhi selam-: "**O Ebu Umejr, çfarë bëri Negir?**". [Buhariu 6129].

Ebu Umejr një kishte një zog të vogël që quhej Negir, kur ngordhi fëmija i vogël u zemërua. I Dërguari -alejhi selam- luante me të vegjlit dhe i fliste çdo njeriu duke iu përshtatur atij.

Shafiu kaloi tërë natën duke nxjerrë dobi nga ky hadith. Thuhet se ai ka nxjerrë më

shumë se një mijë dobi. Kur u thërrit ezani i sabahut Shafiu u ngrit dhe nuk mori abdes e më pas u largua për në shtëpinë e tij. Imam Ahmedi kur e lavdëronte i thoshin: “O Ebu Abdullah, si e lavdëron ti këtë njeri, i cili hëngri, piu, fjeti, nuk u ngrit për namaz nate dhe namazin e sabahut e fali pa abdes?” Imami e pyeti Shafiun dhe ai tha: “Hëngra sa e boshatisa enën, sepse nuk kam gjetur ushqim më të mirë se ushqimi i imam Ahmedit. Nuk u ngrita për namaz nate, sepse dija është më e mirë se namazi i natës. Nuk mora abdes për namazin e sabahut, sepse isha me abdes prej namazit të jacisë.

Këmbëngulja për kërkimin e dijes është shumë e rëndësishme. A jemi këmbëngulës për këtë? Jo. Ata të cilët mësojnë në shkollat shtetërore kur kthehen prej mësimeve merren me gjëra të cilat nuk i ndihmojnë për mësimet.

Po sjell një shembull dhe nuk dëshiroj që të ketë të tillë.

Një nxënës në disa lëndë jep përgjigje të dobëta. Mësuesi i thotë: “Përse?” Ai thotë: “Humba çdo shpresë për ta kuptuar këtë lëndë dhe nuk e mësova atë, por thjeshtë dua ta kem atë.” Si humbe shpresë? Ky është një gabim i madh, duhet të këmbëngulet deri sa të arrihet qëllimi.

Ka thënë shejhu këmbëngulës, Abdurrahman es-Sadi –Allahu e mëshiroftë!– përmendet nga Kesai, imam i Kufës në Nahua (gramatikë) se ai kërkoi njohuritë e Nahuas (gramatikës) dhe nuk e përvetësoi. Një ditë prej ditësh pa një milingonë që mbante ushqimin e saj e me të po ngjitej në mur. Sa herë që ngjitej binte, por ajo këmbëngulte deri sa e ngjiti murin. Kesai tha: “Kjo milingonë këmbënguli deri sa arriti qëllimin dhe ai këmbënguli deri sa u bë imam në Nahua (gramatikë).

Nxënësi i dijes nuk duhet të humbasë shpresat, sepse ajo mbyll derën e së mirës. Nuk duhet të jemi pesimistë, por të jemi optimistë dhe të përgatisim për veten të mirat.

### **Së treti: Të mësuarit përmendësh**

Nxënësi i dijes duhet të sigurohet për atë që mëson, ose ta ruaj atë në gjoks, ose me shkrime, sepse ai nëse nuk do t’i kthehet dhe të përsërisë çfarë ka mësuar ajo (dija) do t’i humbasë dhe do ta harrojë.

Rrugët që të ndihmojnë në ruajtjen e dijes dhe saktësinë e saj është që të drejtohet me të.

Allahu thotë: **"Ndërsa për ata që drejtohen, Ai ua shton edhe më udhëzimin e tyre (në të vërtetën) dhe u dhuron atyre përkushtimin (në këtë Rrugë)".**

[Muhamed, 17]



Allahu thotë: "**Dhe Allahu ua shton udhëzimin atyre që ecin drejt ...**" [Merjem, 76]

Sa herë që njeriu punon me dijen e tij, Allahu i shton të mësuarit dhe të kuptuarit duke e përfshirë me thënien: "**... Ai ua shton edhe më udhëzimin e tyre (në të vërtetën) ...**"

### **Së katërti: Ndjekja e dijetarëve**

Nxënësi i dijes duhet të kërkojë ndihmë tek Allahu e më pas te dijetarët. Të kërkojnë ndihmën e tyre për atë që kanë shkruar në to, sepse kjo shkurton kohën e leximit. E kundërta ndodh për atë të cilin ulet te një dijetar, i cili i sqaron, i shpjegon dhe i ndriçon atij rrugën.

Është e qartë se dija nuk merret vetëm të shujuhët, por ajo merret edhe duke lexuar. Në të shumtën e rasteve ai nëse nuk përkushtohet me një përkushtim të plotë natë e ditë dhe nuk i jepet të kuptuarit, do të gaboje shumë.

Rruga më e mirë është që dija të merret nga shujuhët. Nxënësi i dijes këshillohet që të mos kapë shumë shujuh për një fushë të vetëm.

P.sh.: të mos e mësoj fikun nga më shumë se një shejh, sepse dijetarët ndryshojnë në rrugën e argumentimit, në mendime. Nëse e merr dijen e fikhut prej shumë shujuhëve, cili do të jetë qëndrimi yt në shume çështje, sepse ata kanë mendime të ndryshme në to, pa dyshim, do të jesh në luhajtje e dyshim. Ti merr një dijetar për fikun, tjetër për retorikën e kështu me radhë dhe do të kesh një rehati të plotë.

### **Rrugët e marrjes së dijes**

Njeriu kur kërkon një vend patjetër duhet të njohë rrugët të cilat të çojnë për tek ai. Kur rrugët shtohen, ai kërkon të gjej më të afërtën dhe më të shpejtën. Është e rëndësishme për nxënësin e dijes që ta ndërtojë dijen e tij mbi baza dhe jo mbi rastësitë. Kush nuk siguron bazat i ndalohet mbërritja.

Bazat janë: Dija, çështjet e degëzuara si trunгу i pemës, degët e saj nëse nuk do të jenë mirë në trunгу ato do të prishen.

Por çfarë janë bazat?

A janë ato argumente të qarta?

A po rregulla ?

A po të dyja?

Bazat janë argumente të Kuranit dhe Sunetit si dhe rregulla që merren me ndjekje që dalin prej Kuranit dhe Sunetit.

Këto janë më të rëndësishmet për nxënësin e dijes.

P.sh.: vështirësia pasohet me të lehtë, kjo është prej bazave të nxjerra nga Kurani dhe Suneti.

Nga Kurani, Allahu thotë: **"... Ai ju ka zgjedhur ju (për të përhapur Mesazhin e Tij të Islamit) dhe nuk ka vënë mbi ju ndonjë mundim në fe..."**. [Haxh, 78]

Nga Suneti, thënia e të Dërguari i Allahut -alejhi salam- për Umran bin Husejn kur ai e pyeti për namazin: **"Falu në këmbë, nëse nuk mundesh ulur, nëse nuk mundesh shtrirë"**. [Shënuar nga Buhariu]

Si dhe thënia tjetër: **"Kur t'ju urdhëroj ju me një çështje hajdeni me të sa të mundeni"**. [Shënuar nga Buhariu]

Kjo është baza e nëse të vijnë një mijë çështje me pamje të ndryshme gjykoji ato mbi këtë bazë, në qoftë se baza mungon atëherë çështja do të përzihet.

Për marrjen e dijes ka dy rrugë:

1. Ta marrë atë prej librave të besueshme, të cilat janë shkruar prej dijetarëve të njohur me dijen e tyre si dhe me akiden e tyre të pastër prej bidateve. Marrja e dijes në barkun e librit e çon njeriun në një qëllim të caktuar, por aty ka dy pengesa:

**Pengesa e parë:** Kohëzgjatja. Njeriu humbet një kohë të gjatë, bënë durim dhe përpjekje për të arritur te dija, por kjo pengesë nuk e forcon të shumtën e njerëzve, sepse njeriu humbet kohën pa ndonjë dobi si dhe e pushton atë përtacia, humbja e shpresës e nuk arrin atë që ai ka për qëllim.

**Pengesa e dytë:** Ai që e merr dijen nga barku i librit në të shumtën e rasteve dija e tij është e dobët, pasi ajo nuk ndërtohet mbi rregullat apo bazat. Pikërisht ata të cilët e marrin dijen në këtë mënyrë kanë gabime të shumta, sepse nuk kanë baza ku të mbështeten dhe të ndërtojnë hollësitë që janë në Kuran dhe Sunet.

Disa njerëz marrin si hadith atë që nuk është përmendur në librat e besueshme të

hadithit si në saktësi edhe në zinxhir. Kjo rrugë është në kundërshtim me bazat e besueshme të dijetarët dhe tek umeti (njerëzit). Më pas me këtë hadith ndërton akiden e tij ku padyshim kjo është një gabim, sepse në Kuran dhe Sunet qarkullojnë hollësisht, të cilat duhet të kthehen te bazat e nëse ato bien në kundërshtim me bazat duhet t'i lihen.

2. Prej rrugëve që të çon te dija është dhe mësuesi i besueshëm në dijen e tij. Kjo është rrugë e shpejtë dhe e sigurt për marrjen e dijes, sepse me rrugën e parë nxënësi humbet prej keqkuptimit të tij ose nga dije e mangët ose prej shkaqe të tjera.

Rruga e dytë ka dialogun, marrje përgjigje me dijetarin, të cilat i hapin nxënësit dyert e shumta për të kuptuar dhe të vërtetuar se si të mbrojë thëniet e sakta dhe t'i përgjigjet thënieve të dobëta.

Nxënësi i dijes duhet të fillojë me më të rëndësishmet me njohuritë e shkurtra para atyre të gjata e duke i ndjekur ato shkallë pas shkalle, si dhe të mos kalojë në shkallën tjetër pa u siguruar tek ajo e para, me qëllim që kalimi të jetë i shëndoshë.

## Gabime që kërkojnë kujdes

Disa nga gabimet që kryejnë nxënësit e dijes janë:

**Zilia:** Urrejtja në begatinë që Allahu i jep dikujt tjetër dhe nuk kërkon largimin e saj ndaj tjetrit. Si do që të jetë kjo kërkon largimin apo qëndrimin e begatisë, ajo është zili, sepse ai e urren atë.

Shejhul Islam Ibn Tejmia – Allahu e mëshiroftë! – ka thënë: " Zilia është urrejtja e njeriut për begatinë që Allahu i ka dhënë dikujt tjetër".

Zilia mund të jetë edhe e detyrueshme, siç vjen në hadithin: "*Kur ke zili mos bë padrejtësi, kur dyshon mos e vërteto*". Njeriu kur sheh në zëmrën e tij zili ndaj tjetrit nuk duhet t'i bëjë atij padrejtësi me fjalë dhe vepra, sepse ajo është një zakon prej zakoneve të çifutëve.

Allahu thotë ndaj tyre: "**Apo mos kanë zili njerëzit (Muhamedin alejhi selam dhe pasuesit e tij) për çfarë u ka dhuruar atyre Allahu nga Begatitë e Tij? Dhe Ne që më parë i kishim dhënë familjes së Ibrahimit Librin dhe Hikmetin (Es-Suneh – Frymëzim Hyjnor për ata Pejgamberë, i cili nuk është i shkruar në formë libri) dhe u dhuruam atyre mbretërim madhështor**". [Nisa, 54]

Ziliqari bie në të ndaluara:

1. Urrejtja në caktimin e Allahut. Urrejtja në begatinë e Allahut për dikë, është urrejtje ndaj caktimit të Allahut, si dhe bie në kundërshtim me gjykimin e Allahut.
2. Zilia ha veprat e mira sikurse zjarri drutë, sepse ziliqari në të shumtën e rasteve bën padrejtësi ndaj atij që Allahu e begaton duke i përmendur atij atë që ai urren dhe largon njerëzit prej tij. Kjo është prej gjynaheve të mëdha, e cila rrethohet me të mira.
3. Në zëmrën e ziliqarit bie zjarr, e cila e ha atë. Ai sa herë që shikon begatinë e Allahut te tjetri hidhërohet, i ngushtohet gjoksi, dynjaja si dhe e mbikëqyrë atë (ku ka zili) sa herë që Allahu e begaton atë.
4. Me zilinë i përngjasohet çifutëve. Kush vjen me një ves prej veseve të jobesimtarit ai është prej tyre në këtë ves.

I Dërguari i Allahut thotë: **"Kush i përngjason një populli ai është prej tyre"**. [Shënuar nga Imam Ahmedi]

5. Sidoqoftë zilia e tij dhe sado e fuqishme të jetë, ajo nuk do mundë ta largojë begatinë e Allahut ndaj tjetrit. Kur kjo është e pamundur e si mund të futet kjo zili në zëmrën e tij?!
6. Zilia është në kundërshtim me besimin e plotë. Profeti -alejhi selam-thotë: **"Asnjëri prej jush nuk do të jetë besimtar deri sa të dëshirojë për vëllanë e vet atë që dëshiron për veten"**. [Shënuar nga Buhariu]. E detyroi këtë me qëllim që ta urrejë largimin e begatisë ndaj vëllait të tij. E nëse nuk e bënë këtë, atëherë nuk do për vëllanë tënd atë që do për veten.

7. Zilia e shmang robin për kërkimin të begatisë së Allahut. Ziliqari gjithmonë i kushton vëmendje begatisë që Allahu i jep dikujt tjetër dhe nuk i kërkon Allahut prej begatisë së Tij.

Allahu thotë: **"Dhe mos dëshironi ato gjëra me të cilat Allahu ka bërë që disa prej jush të dallohen nga të tjerët. Për burrat do të ketë shpërblim për çfarë ata kanë fituar dhe për gratë do të ketë shpërblim për çfarë ato kanë fituar dhe kërkoni Allahut nga Begatitë e Tij ..."**. [Nisa, 32]

8. Zilia të çon në përbuzje të begatisë së Allahut. Ziliqari nuk e sheh veten në begatinë e Allahut, kurse atë që ka zili e shikon në begati më të madhe se vetja.
9. Zilia është vepër e dënueshme. Ziliqari ndjek begatinë e Allahut te krijesa në kolektivin e tij, përpiqet me sa të mundet të jetë pengues midis njerëzve dhe atij që

ka zili, duke e poshtëruar atë.

10. Ziliqari të shumtën e rasteve i bën padrejtësi personit që ka zili. Ky merr prej të mirave të ziliqarit, nëse ka, dhe nëse jo, ziliqari merr prej të këqijave të tij e më pas hidhet në zjarr.

Shkurtimisht, zilia është e dënueshme. Me keqardhje kjo më shumë gjendet midis dijetarëve, nxënësve të dijes, gjithashtu edhe midis tregtarëve. Ajo midis dijetarëve, nxënësve të dijes është edhe më e madhe, ndërkohë që këta duhet të jenë më larg zilisë dhe më afër moralit të plotë.

Ti vëlla, kur të shikosh se Allahu i jep dikujt begati, përpigu që edhe ti të jesh si ai e mos e urre atë, sepse zilia nuk ndryshon gjendjen, por thuaj: "O Allah, shtoi atij prej të mirave të Tua dhe më jep mua më mirë se ai!"

## Dhënia e mendimeve në fe pa dije

Dhënia e mendimit në fe zë një vend të rëndësishëm. Dhënësi i mendimit përballet me qartësimin e çështjeve fetare që u përzihen njerëzve duke i orientuar ata në rrugë të drejtë. Këto mendime i nxjerrë vetëm ai që i posedon.

Njerëzit duhet t'i frikësohen Allahut dhe të flasin vetëm me dije. Duhet ta dinë se të Allahut janë krijimi dhe çështja. Nuk ka Krijues veç Allahut, Ai është Rregullatori i çështjeve të krijesës, nuk ka ligj të barabartë me ligjin e Allahut, Ai e bënë obligim ndonjë gjë, Ai e ndalon atë, Ai e bënë ndonjë gjë të pëlqyeshme apo të lejuar.

Allahu e urren atë që lejon dhe ndalon sipas epshit dhe dëshirës së tij dhe thotë: **"Thuaju: 'Më thoni, çfarë të mirash ju ka zbritur juve Allahu! Dhe ju vetë i keni bërë ato të ligjshme e të paligjshme.' Thuaju: 'A ju ka lejuar Allahu (të bëni kështu), apo ju shpifni gënjeshtër ndaj Allahut?'"**

**"Dhe çfarë mendojnë ata që trillojnë gënjeshtër kundër Allahut, për Ditën e Kiametit (a mendojnë se do të falen)? ...". [Junus, 59-60]**

Allahu thotë: **"Por mos thoni në lidhje me atë që jua thotë goja duke gënjyer: 'Kjo është e ligjshme dhe kjo është e ndaluar', që të shpifni gënjeshtër ndaj Allahut, (pasi) me të vërtetë ata të cilët shpifin gënjeshtër ndaj Allahut kurrë nuk do të fitojnë.**

**(Veç) një kënaqësi të shpejtë e kalimtare do të shijojnë, por për ta do të jetë ndëshkim i dhimbshëm". [Nahl, 116-117]**

Është krim i madh për një person kur thotë për një çështje kjo është e lejuar, apo e ndaluar, apo e domosdoshme e në të vërtetë nuk e di gjykimin e Allahut për të. Kjo nuk është vetëm një krim, por dhe një edukatë e keqe me Allahun.

O njeri! Ti e di se gjykimi është te Allahu dhe flet në fenë e Allahut dhe sheriatin (ligjin) e Tij pa dije?!

Allahu e afron thënien pa dije me shirkun (politeizmin), dhe thotë: **"Thuaj: '(Por në të vërtetë) gjërat që i ka ndaluar Zoti im janë El-Fahisha (gjynahet e mëdha, çdo lloj afrimi me gratë jashtë martesës etj) që kryhen hapur ose fshehur, gjynahet (e tjera të çdo lloji), shtypja pa të drejtë, vënia shok Allahut në adhurim, gjë për të cilën Ai nuk ka dhënë asnjë të drejtë e asnjë provë, si dhe përfolja për Allahun për gjëra për të cilat ju nuk keni asnjë dijeni'."** [A'raf, 33]

Këta njerëz, që i japin mendime në fe njeri-tjetrit pa kurrfarë dije duke thënë se kjo është e ndaluar, kjo e obliguar, ose jo e obliguar -dhe në të vërtetë nuk kanë asnjë dije për to- a nuk e dinë këta se Allahu do t'i pyesë Ditën e Gjykimit. Këta në qoftë se i lejojnë dikujt atë që Allahu e ka ndaluar apo ia ndalojnë atë që Allahu e ka lejuar, pranojnë në vetvete gjynahun e tij e mbi ata bie ajo që ai punon, ku shkak është ajo që ata thanë.

Disa njerëz bëjnë krim tjetër kur shikon një person që kërkon mendim te një dijetar ai i thotë se nuk është nevoja të marrësh mendim, sepse kjo çështje është e qartë, kjo është e ndaluar, në të vërtetë ajo është e lejuar. Ose i thotë se kjo është e domosdoshme, në të vërtetë ajo nuk është e tillë. Ky është një krim i tij në sheriatin e Allahut dhe një mashtrim për vëllanë musliman, sepse jep mendime në fe pa patur dije.

Nëse një person pyet për një rrugë prej rrugëve të qytetit dhe i thua që ajo është këtej, e ti nuk e di, a nuk do ta marrin njerëzit këtë si mashtrim? Si mund të flasësh për rrugën e xhenetit dhe ligjin e Allahut pa patur dije për të?

Disa mësues të cilësuar dijetarë bien në pozicionin e njerëzve të zakonshëm, flasin për ligjet e Allahut pa dije, i zbukurojnë ato, por ata janë njerëzit më injorantë në ligjet e Allahut.

Kur flet ndonjëri prej tyre thua sikur ti ketë zbritur shpallje e nuk mund të shqiptojë apo të thotë se nuk e di. Ai me këtë dëmton njerëzit e zakonshëm, sepse njerëzit ndoshta besojnë fjalën e tij dhe mashtrohen me të. Ata thënie ia dedikojnë Islamit duke thënë se Islami thotë kështu, e shikon këtë gjë kështu, por kjo nuk lejohet, vetëm nëse thënësi e di se ajo është prej Islamit. Kjo rrugë është vetëm atëherë kur njihet libri i Allahut, suneti i Profetit -alejhi selam- ose konsensusi i myslimanëve (ixhma).

Disa njerëz me kurajë, pa frikë dhe pa patur turp prej Allahut, thonë për atë që është e ndaluar qartësisht se nuk mendoj të jetë e ndaluar. Po kështu dhe kur është obligim i qartë thotë se nuk mendoj të jetë obligim. Këto veprime të këtyre njerëzve janë ose nga padija për të, ose për inati, ose për të sjellë dyshime robërve të Allahut në fenë e Tij.

Vëllezër! Prej logjikës, besimit, frikës së Allahut dhe lartësimit të Tij, personi për atë që nuk e di duhet të thotë: Allahu është i dijshtëm, pyet tjetër kënd. Kjo është prej logjikës së shëndoshë, sepse njerëzit kur shohin qëndrimin e tij e besojnë atë.

Ky e njeh veten e tij dhe e vendos atë në vendin që i takon. Gjithashtu, prej besimit të plotë dhe frikës ndaj Allahut nuk flitet për fenë e Allahut atë që nuk e di.

Ka qenë i Dërguari i Allahut -alejhi selam- më i ditur prej njerëzve në fenë e Allahut, e pyesnin për atë që nuk i kishte zbritur prej shpalljes, priste deri sa t'i zbriste shpallja. Allahu u përgjigjej për atë që pyetej i Dërguari i Tij.

Allahu thotë: **"Të pyesin ty (O Muhamed) se ç'është e lejuar për ta (për t'u ushqyer). Thuaj: Të lejuara për ju janë Et-Tajjibat (të gjitha ushqimet e mira dhe të pastra, të lejuara nga Allahu)..."** [Maide, 4]

Allahu thotë: **"Të pyesin ty (O Muhamed) edhe për Dhulkarnejnin. Thuaju: 'Unë do t'ju rrëfej diçka nga historia e tij'."** [Kehf, 83]

Allahu thotë: **"Të pyesin ty (O Muhamed) për Orën (Çastin e Fundit të kësaj bote dhe fillimin e Jetës së Pasosur): 'Kur është përcaktuar koha e tij?' Thuaju: 'Dija për të është Vetëm tek Zoti im. Askush nuk ta shpall kohën e tij përveç Atij ...'"** [A'raf, 187]

Kanë qenë nga më të mëdhenjtë e sahabëve kur i paraqiteshin çështje dhe nuk e dinin gjykimin e Allahut për të, heshtnin.

Ka thënë Ibn Mes'udi – kënaqësia e Allahut qoftë me të!–: **"O njerëz! Kush pyetet për dije dhe e di atë le ta thotë. Kush pyetet dhe nuk ka dije le të thotë Allahu është i dijshtëm, sepse për atë që nuk e di, është prej dijes të thuash: Allahu është i dijshtëm".**

U pyet Shabiu për një çështje dhe tha: **"Nuk e zotëroj."** Shokët e tij i thanë: "Të turpëruam." Ai tha: **"Melekët nuk u turpëruan kur thanë: ' ... Ne nuk dimë asgjë më tepër nga ç'na ke mësuar Ti' ...'"** [Bekare, 32]

Ka shembuj të shumtë, për dhënien e mendimeve pa patur dije, prej tyre është të

sëmuri kur i ndoten rrobat, nuk mund t'i pastrojë ato, por i thonë: 'Ti nuk falesh deri sa ato të pastrohen.' Ky është një mendim i gabuar dhe i rremë. I sëmuri, nëse nuk ka mundësi që të pastrohet, falet edhe sikur rrobat apo trupi i tij të jenë të papastër.

Allahu thotë: **"Kini pra frikë Allahun dhe përmbushni detyrimin e Tij sa të mundeni..."** [Tegabun, 16]

I sëmuri falet sipas mundësisë që i jepet. Falet në këmbë, nëse nuk mundet ulur, nëse nuk mundet shtrirë duke përkulur pak kokën dhe nëse nuk mundet me sy. Në qoftë se është me mëndje të shëndoshë le të bëjë nijetin e veprave me zemër dhe t'i thotë thëniet me gojën e tij. P.sh. të thotë: Allahu ekber, më pas të këndojë Fatihan dhe një sure, më pas të thotë: Allahu ekber dhe ta bëj nijet sikur është në ruku, më pastë thotë: Semiall-llahu limen hamideh, të bëjë nijet sikur është ngritur nga rukuja, më pas të njëjtën gjë vepron edhe në veprimet e mbetura. Bën nijet, me zemrën e tij, për veprimet që nuk ka mundësi t'i kryejë dhe nuk duhet ta vonojë namazin nga koha e vetë.

Si shkak i mendimeve të rreme dhe të gabuara, disa muslimanë, largohen nga kjo botë pa u falur. Po ta dinin se i sëmuri falet sipas mundësisë që ka do të largoheshin nga kjo botë me namaz.

Në këto çështje dhe në të tjera të ngjashme me to, njerëzit e zakonshëm duhet të marrin gjykimin e tyre prej dijetarëve, me qëllim që ta njohin gjykimin e Allahut dhe të mos flasin në fenë e Allahut për atë që nuk e dinë.

## Mendjemadhësia

I Dërguari i Allahut -alejhi selam- e komentoi dhe e qartësoi këtë duke thënë: **"Mendjemadhësia është mosmirënjohja e së vërtetës dhe përbuzja e njerëzve"** [Shënuar nga Muslimi]

Mosmirënjohja e së vërtetës është refuzimi i saj dhe përbuzja e njerëzve.

Prej mendjemadhësisë është refuzimi ndaj mësuesit tënd, zgjatimet dhe edukata e keqe me të.

Te disa nxënës kur dikush e lajmëron me një gjë, e cila nuk ndodhet te ai, ai e përbuz atë dhe nuk e pranon. Kjo është një mangësi në të punuarit me dijen.

Thuhet :



Dija është lufta, për djalin mendjemadh

Si përroi që lufton me vendin e lartë

Djali mendjemadh nuk mund ta marrë dijen, sepse dija për të është një luftë, si përroi që lufton me vendin e lartë, i cili nuk e lë të zërë vend, por e zhvendos majtas e djathtas. Kështu dhe dija nuk mund të qëndroj me mendjemadhësinë, nga ky shkak ajo largohet.

## Ashpërsia në medhhebet dhe mendimet

Nxënësi i dijes duhet të largohet nga:

Grupacionet dhe partitë sa që e ulin bindjen dhe sinqeritetin në një grup apo parti të caktuar. Kjo, padyshim, është në kundërshtim me rrugën e selefëve (të parëve tanë).

Selefët, punëmirët nuk kanë qenë parti, por partia e tyre ishte një, e cila përfshihej nën fjalën e Allahut "**... Është Ai (Allahu) që ju ka emëruar ju muslimanë edhe më parë (ata që ishin në Fenë e Tij, në Islam si Ibrahim i ndjekësit e rrugës së tij) ...**" [Haxh, 78]

Nuk ka parti, as ndihmues, as armiqësi, por vetëm sipas asaj që është në Kuran dhe Sunet.

Ka prej njerëzve që grupohen me një grup të caktuar, zgjedhin rrugën e saj dhe argumentohet me argumente, të cilat mund jenë ndaj tij, mbron tjetër veç saj dhe humbet çdo gjë të ngjashme me të edhe sikur të jetë më afër të vërtetës se ajo. Merrë të dyja si fillim. Kush nuk është me mua është kundra meje, kjo është një fillim i shëmtuar, sepse ka të ndërmjetme midis teje dhe ndaj teje. Në qoftë se është ndaj teje me hak, në të vërtetë është me ty, sepse i Dërguari i Allahut -alejhi selam- thotë: "Ndihamoje vëllanë tënd që bën padrejtësi ose që i është bërë padrejtësi". Ndihma për të padrejtin është ta ndalosh atë kur bën padrejtësi.

Kur u shfaqën partitë te muslimanët u shtuan rrugët, u përça umeti, arriti që të humbasin njëri-tjetrin dhe hanin mishin e vëllait të tyre të vdekur, i kapi ata dështimi, siç thotë Allahu: "**... mos u kundërshtoni (me njëri-tjetrin) që të mos humbni kurajën dhe të mos ju lënë fuqitë ...**" [El Enfal, 46]

Gjejmë disa nxënës dije te një shejh prej shujhve, e ndihmon atë në të vërtetën dhe në të kotën dhe armiqëson të tjerët të ngjashëm me të. E bën të humbur dhe bidatçi.

Ai e shikon shejhun e tij si dijetar rregullues, kurse të tjerë ose injorantë, ose

shkatërrues. Ky është një gabim i madh, por fjala duhet të merret kur ajo është e pajtueshme me Kuranin dhe Sunetin dhe thënien e sahabëve – kënaqësia e Allahut qoftë me ata të gjithë!–.

## Burimi para të qënurit kompetent

Nxënësi i dijes duhet të tregojë kujdes për burimin para se të flasë për këtë, nëse ai e bën këtë ka këto argumente për çështjet:

**Çështja e parë:** Admirimi i vetes kur nxjerr diçka e bën atë që ta shohë veten më të ditur.

**Çështja e dytë:** Ajo tregon të moskupturit dhe mos njohjen e tij për çështjet, sepse kur ai jep burimin ndoshta bie në një çështje që nuk mund të dalë dot prej saj. Kur shikojnë burimin e tij i përgjigjen në çështjet që i qartësojnë atij defektin.

**Çështja e tretë:** Kur jep burimin para të qënurit kompetent detyrohet të thotë ndaj Allahut atë që nuk e di, sepse në të shumtën e rasteve ky është qëllimi i tij.

Atij nuk i bënë përshtypje, sa herë që pyetet përgjigjet duke shfaqur rrezik në fenë e tij dhe në thënien e tij ndaj Allahut, pa dije.

**Çështje e katërt:** Personi që jep burimin pa qenë kompetent në të shumtën e rasteve nuk e pranon të vërtetën, sepse mendon se po i përulet dikujt edhe nëse me të është vërteta kjo është argument se ai nuk është dijetar.

## Mendimi i keq

Nxënësi i dijes duhet të tregojë maturi me qëllim të mos mendojë keq për dikë tjetër. P.sh t'i thotë se nuk e vërteton këtë vetëm syfaqësisht, nuk e bën këtë pyetje vetëm për syfaqe me qëllim që ta njohin se është nxënës që kupton.

Hipokritëve kur u vinin besimtarët me lëmoshë, nëse ajo ishin madhe thoshin se kjo është syfaqësi, nëse ishte e vogël thoshin: "Allahu nuk ka nevojë për këtë lëmoshë".

Allahu thotë: **"Ata të cilët marrin nëpër gojë dhe tallen me besimtarë të atillë që japin sadaka me vullnetin e tyre dhe (me) ata të cilët nuk mundën që të gjejnë për të dhënë sadaka përveçse çfarë kanë në dorë, Allahu do t'ua përplasë vetë atyre përqeshjen dhe për ta do të ketë dënim të dhimbshëm".** [Teube, 79]

Mjerë për atë që mendon keq ndaj atij që shfaq drejtësi. Të menduarit keq nuk ka

dallim midis mësuesit tënd ose shokut tënd, por është detyrë të jetë mendimi i mirë për atë që shfaq drejtësi. Për atë që nuk shfaq drejtësi nuk ka problem të kihet mendim të keq për të, por patjetër duhet të vërtetohet derisa të largohet nga vetvetja ky iluzion, sepse disa njerëz mendojnë keq për tjetrin duke e krijuar këtë me iluzion të rrejshëm që nuk ka asnjë të vërtetë.

Është detyrë kur ka mendim të keq për dikë qoftë prej nxënësve të dijes apo të tjerë, patjetër duhet parë a ka arsye që të çon ky mendim i keq, nëse ajo vjen si rezultat i iluzioneve atëherë nuk lejohet që të ketë mendim të keq për një musliman që shfaq drejtësi.

Thotë Allahu: **"O ju që keni besuar! Mënjanoni shumë dyshime ..."** [El Huxhurat, 12]. Nuk thotë kini dyshim, sepse disa dyshime kanë origjinë, kanë justifikim. Thotë Allahu: **"...Vërtet mjaft nga dyshimet përbëjnë gjynahë..."** [El Huxhurat, 12]. Jo çdo dyshim, sepse dyshimi që krijon armiqësi, urrejtje pa ndonjë arsye padyshim është mëkat. E njëjtë është dhe me dyshimin që nuk ka asnjë pikë mbështetje. Nëse ka mbështetje mbi bazën e argumenteve nuk përbën ndonjë problem të kihet mendim të keq, por njeriu duhet ta vendosë veten në vendin e tij duke mos e tepruar në të me të paqena.

Në të tilla gabime duhet të tregohet kujdes, sepse Allahu nxënësin e dijes e ka ndriçuar me dije dhe e ka bërë shembull sa që Allahu ka lënë dijetarët që t'u përgjigjen çështjeve të njerëzve kur kanë paqartësira dhe thotë: **"...kështu që pyetni njerëzit e Mesazhit (të Teuratit dhe të Inxhilit) nëse nuk e dini ..."** [El Enbija, 7]

Gjithashtu thotë: **"Kur atyre u vjen rëndë ndonjë çështje që prek sigurinë e njerëzve apo frikë, ata e përhapin atë (ndër njerëz). Sikur t'ia kishin paraqitur atë (për shqyrtim) të Dërguarit apo njerëzve të tjerë drejtues të tyre, shqyrtuesit përkatës do ta kishin kuptuar atë prej tyre..."** [An Nisa, 83]

T'i o nxënës i dijes nuk duhet të biesh në shkallën e poshtërit, por duhet të jesh aty ku e meriton.

## Librat e kërkuesit të dijes

Para fillimit të kësaj pjese për kërkuesin e dijes patjetër duhet të qartësojmë disa çështje të rëndësishme.

Sjellja me librin, e cila është:

a) Njohja e temave të tij me qëllim që njeriu të përfitojë, sepse ai e ka më se të

nevojshme specifiken, pasi libri mund të jetë mashtrim, i pavlefshëm ku e kërkon patjetër njohjen e temave të tij.

b) Njohja e nomenklaturës, pasi me të arrin të ruash kohë të madhe. Këtë gjë veprojnë dijetarët në hyrjen e librave. Për shembull: e dimë se autori i librit " Bulugul meram " kur thotë: mutefakun alejhi, ka për qëllim që transmetohet prej Buharit dhe Muslimit. E kundërta ndodh tek autori i librit "El munteka" kur thotë: mutefakun alejhi, ka për qëllim që transmetohet prej Imam Ahmedit, Buhariut dhe Muslimit. I njëjti ndryshim ndodh edhe në librat e Fik'ut. Çdo autor ka nomenklaturën e tij dhe për këtë ne duhet ta njohim.

c) Njohja e metodës dhe e frazave të tij, sepse kur lexon librat e mbushur me dije nuk ka dyshim se do të hasësh me fraza që për kuptimin e tyre kanë nevojë për meditim, thellim.

Leximi i librave bëhet në dy lloje:

a) Lexim meditimi dhe kuptimi ku njeriu patjetër duhet të mendojë dhe të tregoj maturi.

b) Lexim eksplorimi, duke parë nëpërmjet kësaj vetëm temat e librit dhe çfarë mund të ketë në të prej kërkimeve, ku me anë të së cilës arrin të njihet me gjithëpërfshirjen e librit. Rruga e përshtatshme e leximit të librit, meditimit dhe kuptimit të tij është dhe kërkimi i ndihmës te njerëzit me dije të pastër. I pari libër që e kërkon këtë meditim dhe maturi është Libri i Allahut, prandaj kërkohet durim dhe këmbëngulje dhe nuk ka mirësi më të madhe që i është dhënë njeriut se sa durimi.

Mbledhja e librave

Kërkuesi i dijes duhet të mbledhë libra duke filluar nga ato që janë më të rëndësishme.

Përqendrimi në librat e rëndësishëm

Kërkuesi i dijes duhet të tregojë kujdes të veçantë në librat bazë duke iu shmangur botimeve të rejave, sepse disa autor të rinj nuk kanë dije të mjaftueshme dhe kur lexon shkrimet e tyre do të gjejsh gjëra të përcipta. E përcjellin diçka me shprehjet e tyre me fjali të gjatë, e cila bëhet lëmsh. Patjetër duhet t'i kthehemi librave bazë të selefëve, të cilat janë shumë herë më të mira dhe më të begata se ato që pasojnë. Shumica e librave të atyre që kanë ardhur më vonë kanë pak kuptim dhe shumë përbërje. Lexon një faqe të plotë dhe e përmbledhë atë me një ose dy rreshta, ndërsa te librat e selefëve gjen lehtësi, ëmbëlsi, përmbajtje të lehtë dhe nuk ka fjalë që të mos ketë kuptim. Librat që duhen të kihen parasysh prej kërkuesit të dijes janë

librat e Shejhut islam Ibn Tejmije, Ibn El Kajim.

Vlerësimi i librave

Librat ndahen në tre pjesë:

a) libra të mirë;

b) libra të keq;

c) libra që nuk kanë as mirësi e as të keqe.

Kujdesu që libraria jote të jetë e zbratur prej librave që nuk kanë mirësi. Ka libra të dëmshme që përmbajnë mendime dhe rrugë të caktuar edhe këto mos i prano në librarinë tënde, sepse librat e bidatit të dëmtojnë në akide dhe librat e rebelizmit të dëmtojnë në menhexhin (rrugën). Largohu prej çdo libri që është i dëmshëm, sepse librat janë ushqim për shpirtin si ngrënia dhe pirja për trupin e nëse ushqehesh me këto libra të dëmshëm padyshim devijohet prej besimit dhe rrugës së saktë.